

ROBERT SHKURTI
UDHA E SHPRESËS
TREGIME DHE NOVELA

BOTIMET TOENA

ROBERT SHKURTI

UDHA E SHPRESESË

tregime dhe novela

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-327-16-1

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Parathënie

Një prozë e re dhe realiste, që sjell dramën e emigrimit në letërsinë shqipe!

Robert Shkurti ka më se një dekadë që me romanet, tregimet dhe poezitë e tij është bërë një shkrimtar i njohur dhe i dashur i letërsisë shqipe. Hyrja e tij në letërsi fillon në Itali me vëllimin me tregime “Sotto il cielo delle aquile” (*Nën qiellin e shqiponjave*). Më pas pasojnë dy romane “Drejt jetës” me temë shoqërore si dhe “Ndërmjet dy kohëve” me temë emigracionin, temë të cilën duhet thënë që e njeh mjaft mirë. Roberti më pas do të vazhdojë me një vepër voluminoze siç është romani “Luftë dhe tragjedi në Suharekë”. Ndonëse me pak vonesë, ishte një ngjarje, jo vetëm për mua, por për të gjithë ata që e kanë lexuar romanin e tij me temë lufta e Kosovës.

Më pas shkrimtari Robert Shkurti, për çudi, kalon te poezia.

I lindur në qytetin e bukur të Durrësit, pranë detit, nuk është një rastësi dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Libri i tij me poezi “Regëtimë deti” ku ka thurur vargje për detin e tij të dashur, e afirmon më së miri këtë gjë. Më pas

vijon vëllimi poetik “Ajër shprese” ku lirikat zënë vendin kryesor. Së fundmi, ai na surprizon me një gjini tjetër të poezisë, me Haikun e shkurtër japonez, trevargësh, ku deti është metafora gjigante për të.

Robert Shkurti dhe në prozë, ashtu si në poezi sjell poezinë e prozës sa realiste aq edhe moderne, në qoftë se me modernizëm do të kuptojmë trajtimin artistik të temave aktuale.

Befasuese ishte telefonata e tij, nga larg, ku më njoftonte se së shpejti do të niste për në shtyp librin e tij më të ri me tregime “Udha e shpresës” dhe më kërkonte një mendim paraprak për të.

E prita me padurim këtë libër të ri, dhe e lexova me një frymë. Janë gjithsej 26 tregime, që të japin përshtypjen e një mozaiku me një personazh lirik, që lëviz në kohë dhe në hapësirë. Janë mozaikë të një jete që nis qysh nga vitet e tij të rinisë dhe përfundon me ngjarje jetësore të një emigranti.

Autori Robert Shkurti, ashtu siç e përshkruan dhe vetë ai tek tregimi “Për një jetë më të mirë”, pas viteve 90-të, u nis për një jetë më të mirë. Sipas përshkrimeve që do të gjejmë në këtë libër, jeta matanë detit kishte të mirat dhe të këqijat e saj, ashtu si dhe jeta përkëtej detit, kryesisht para viteve 90-të, ka pasur bukurinë e saj, por dhe vështirësitë e saj.

Ky libër i ri me tregime është ndërtuar me mbresat e dy realiteteve, të matanë detit dhe të përkëtej detit... Shumë emocione ndien kur lexon sidomos tregimet e kohës së rinisë së autorit. Ikën autori nga Shqipëria, por nuk ikën Shqipëria nga autori. Largohet autori nga Durrësi, por nuk largohet Durrësi nga autori. Ah! Durrësi i viteve të rinisë... Durrësi,

i cili është përshkruar aq bukur në disa tregime të këtij libri, por dhe në romanin “Ndërmjet dy kohëve”, Durrësi i viteve të shkollës, Durrësi i viteve të dashurisë së parë... Durrësi është qyteti i ëndrrave dhe i netëve pa gjumë të autorit, ndaj, si mund të mos e mbartte me vete dhe si mund t’i linte pa hedhur në letër histori dhe çaste aq të bukura, të cilat përshkruhen te tregimet “Midis dy dashurive”, “Mall” “Keqardhje”. Veçanërisht mbresëlënëse janë dy tregimet e para, “Vrasje për vetëmbrojtje” dhe “Monda”, të cilat në një formë origjinale pasqyrojnë pasojat e kurbetit.

Ajo që të bën veçanërisht përshtypje te tregimet e Robert Shkurrit, është përshkrimi me hollësi i disa intimiteteve dhe detajeve jetësore, përshkrimi me realizëm dhe vërtetësi i personazheve si dhe portretizimi jo vetëm i karaktereve që trajton, por edhe i botës njerëzore... Tregimet e tij përshkohen nga realizmi i thellë, një realizëm që hyn natyrshëm në gjendjen tënde shpirtërore, kur kujton se dhe ti vetë duhet t’i kesh kaluar ato emocione të pritjeve djaloshare, kur zemra nis e të rreh fort, kur sheh vajzën e dashur të kalojë në trotuar, apo çastet e takimit të parë...

Te tregimet me kujtimet e rinisë personazhet janë autentike. Është një botë e varfër si në veshje ashtu edhe për sa i takon mentalitetit të kohës, por e gëzuar, ëndërrimtare dhe plot emocione. Është koha e rinisë me ngjarjet dhe personazhet e saj të çiltra, të cilat çuditërisht autori i ka ruajtur me kujdes, për të ardhur një ditë që t’ia transmetojë lexuesit si një dhuratë të çmuar, të cilën mund ta çmojë dhe dhurojë vetëm një autor i besueshëm, i ndjeshëm dhe i vërtetë, shkrimtari Robert Shkurri.

Në tregimet e Robertit ka shumë jetë, por dhe shumë kolor në përshkrimin dhe gjuhën e personazheve. Ka shumë kolor të karaktereve shqiptare dhe të jetës shqiptare. Autori tregohet një njohës i hollë jo vetëm i ngjarjeve që përshkruan me imtësi, por edhe i tipave dhe karaktereve të veçantë... Për ilustrim do të doja të përmend tregimin “Për një jetë më të mirë”, ku autori përshkruan me ngjyra të forta realiste emocionet që ndien një i ri shqiptar, në çastin që ai gjendet brenda një gomoneje, me njerëz të panjohur, në drejtim të një jete tjetër, në një natë të errët. Në këtë tregim, më tepër se në çdo tregim tjetër merr kuptim titulli i këtij libri “Udha e shpresës”. Astriti dhe Kastrioti, të dy shqiptarë të nisur në emigracion, njeri person i ndershëm dhe tjetri, Kastrioti, njeriu i aventurave, i lidhur me korrupsionin, janë dy tipa, të cilët i lidhi për një çast jeta dhe i largoi përfundimisht fati. Kastrioti përfaqëson ato personazhe që e kërkonin suksesin duke u marrë me punë të pista.

Gjinia e tregimit është prova e zjarrit për një shkrimtar. Miku im, Robert Shkurti, sikur e ka pasur parasysh thënien e shkrimtarit Gourmond kur thotë: “Nuk ka libra më të mirë se ata kur një shkrimtar është duke shfaqur vetveten në rrëfimin e sjelljes së bashkëkombësve të vet” si dhe porosinë e shkrimtarit çek, M. Kundera, ku thotë: “çdo shkrimtar pi ujë në pusin e vet”. Shkrimtari Robert Shkurti, e mbush kovën e ujit të kujtimeve në pusin e vet.

“Udha e shpresës” është një tregim i jetuar, plot dramacitet, të cilin e kam lexuar me një emocion të veçantë, edhe për shkak të vërtetësisë së detajeve, të cilat në disa raste kalojnë në natyralizëm.

“Imagjinata është vlerë”, thotë Kundera, por realiteti shpeshherë është dhe më me vlerë sesa imagjinata e një autori... “Zoti im, mos më lejo të gjykoj dhe të flas për atë që nuk e njoh dhe nuk e kuptoj”, thoshte Çehovi. Tregimet e Robert Shkurtit, janë si të thuash mbresa dhe copëza jete, nga jeta e tij e shtrirë në dy kohë dhe në dy realitete relativisht të ndryshme.

Koha e jetuar matanë detit, edhe pse me vështirësitë e veta dhe dramën e veta, që përshkruhet aq bukur tek tregimi “Jetë e vështirë” dhe “Një dhuratë e papritur”. Te ky i fundit autori shpreh emocionet për të papriturën e tyre të këndshme, kur u vjen letra nga Bashkia e qytetit se u është akorduar një apartament i bollshëm për të jetuar tashmë si njerëz të lirë. Kjo gjë mund të ndodhë jo përkëtej detit, por përtej detit. Jeta në emigracion zë faqet më të bukura, më realiste dhe më prekëse të këtij libri. Të tilla janë tregimet “Pengu”, “Engjëlli vrasës”.

Lënda e përmbledhur në këtë libër është substanciale dhe nuk është rastësore. Autori ka ditur të vëzhgojë përreth tij dhe ka ditur të veçojë si të rëndësishme për artin e të rrëfyerit, ato ngjarje që mbartin një ide dhe ato personazhe që e përçojnë këtë ide te lexuesit. Në tregimin “Në rrugën e xixëllonjave” vërehet kontrasti midis emrit poetik dhe vrazhdësisë së degjenerimit të një shoqërie ku trupi shitet ose përdoret për sigurimin e bukës së përditshme. Tri tregimet, që do të vazhdojnë, “Revoltë e brendshme në kohën e Atij”, “Kandidati i partisë” dhe “Leximi i veprave”, të duken si tri skica të një realiteti të kaluar.

Në fund, do të doja t'i mbyllja këto shënime, për librin më të ri dhe të mrekullueshëm të autorit Robert Shkurti, me një fragment domethënës nga pasthënia e tij “Të jesh emigrant”.

“Të jesh emigrant do të thotë të jesh i nënshtruar për çdo gjë, njëlloj si kau kur e vënë në zgjedhë. Të pranosh të bësh çdolloj pune, edhe pse mund të kesh mbaruar studimet e larta e je i pajisur me dije e njohuri shumë herë më tepër se punëdhënësi yt. Pra, të mallkosh veten kur shikon se çfarë pune të rëndomtë bën në krahasim me aftësitë e tua. Të jetosh gjithmonë me frikën e dëbimit, në rast se humb vendin e punës. Të mos ndihesh asnjëherë i sigurt, asnjëherë me këmbët në tokë.”

Këto shënime i shkruan autori, i cili, dhe atje ku jeton, krahas punës së përditshme, bën dhe një punë tjetër intelektuale, të mirëfilltë, modeste dhe tepër të suksesshme, me të cilën lartëson çdo ditë veten dhe vendin e vet, Shqipërinë.

Sulejman Mato
Shkrimtar

Vrasje për vetëmbrojtje

Në bankën e të akuzuarit ishte ulur një grua rreth të dyzetave. Ishte e bukur, me tipare tipike të një gruaje mesdhetare: me fytyrë të pastër e lëkurë të shndritshme, sy të zinj, si të ishin dy kokrra ulliri të bëra mirë, hundë të rregullt e buzë të plota. Flokët e zinj i kishte kapur topuz. Megjithatë, fytyra e saj kishte një pamje të lodhur. Qëndronte e heshtur dhe me duart lëshuar mbi prehër. Ishte në pritje të marrjes së vendimit të trupit gjykues. Kishte një tension të brendshëm, që sa vinte e shtohet. Zemra i rrihte pa pushim. Sytë i hidhte herë nga trupi gjykues e herë nga avokati i saj, një burrë afro të pesëdhjetave, i gjatë dhe me flokë të rënë në pjesën e sipërme të kokës. Dukej i vendosur. Fytyra paksa e kuqe dhe sytë e kaltër sikur i thoshin: “Mos ki merak, do t’ia dalim”, çka i dha asaj shpresë dhe guxim. I hodhi sytë nga salla e mbushur plot. Burri dhe fëmijët ishin në radhën e parë. Ai ishte hequr në fytyrë, ndërsa tre fëmijët dukeshin të frikësuar që ajo, mamaja e tyre, ndodhej në bankën e të akuzuarve. U mundua se mos shihte ndonjë nga të afërmit e viktimës, por s’i zunë sytë asnjë. Ktheu përsëri kokën nga trupi gjykues, që po bëhej gati të jepte vendimin. E pushtoi frika.

Kryetari i trupit gjykues, një burrë i gjatë, i hollë e me fytyrë të hequr, u ngrit dhe, si pastroi pak zërin, tha:

- Zonja dhe zotërinj të nderuar, trupi gjykues, pasi shqyrtoi me hollësi e me objektivitet të gjitha faktet dhe dëshmitë e ngjarjes makabër, të ndodhur pak ditë më parë, vendosi për të pandehurën Lindita Fusha masën e arrestit me burg me akuzën “vrasje me paramendim”.

- Uuuuu! - gumëzhiu salla, si të ishte koshere bletësh.

- Është e pafajshme! - u dëgjua një zë i fortë burri.

- E bëri për vetëmbrojtje. Fajin e ka ai maskarai! - ulëriti një i afërmi saj.

- Çfarë bëni, more?! Ka apo s'ka drejtësi?! - bërtiti një tjetër.

Pakënaqësia në dhënien e vendimit krijoi pështjellim. Zhurma sa vinte e shtohet. Kryetari i trupit gjykues u kërkoi të pranishmëve në sallë të mbanin qetësi. Ai goditi disa herë tryezën me çekiçin e drunjtë. Zhurma dalëngadalë nisi të binte e, më në fund, u krijua një heshtje e plotë. Atëherë avokati mbrojtës u ngrit me vrull dhe tha:

- Me leje, zoti kryetar! Kundërshtoj! Kërkoj mbrojtjen e klientes sime.

- Urdhëroni! - i tha kryetari.

- Të nderuar anëtarë të trupit gjykues! I nderuar kryetar i seancës! Kërkoj që për klienten time, Lindita Fusha, të merret masë më e lehtë dhe pikërisht “detyrim paraqitjeje”, për arsye se ajo e ka kryer krimin për vetëmbrojtje dhe nuk ka pasur qëllim që të vrasë shtetasin Altin Guri...

- Jo, zoti avokat, - ia ndërpreu fjalën kryetari i seancës gjyqësore, - e pandehura ka qenë e pajisur me armë të ftohtë. Ajo e ka kryer vrasjen me paramendim.

- Zoti kryetar, - këmbënguli avokati, - jam i bindur dhe jua theksoj përsëri se klientja ime nuk ka pasur asnjë qëllim të vrasë viktimën. Ajo thjesht është vetëmbrojtur dhe ju këtë fakt duhet ta merrni parasysh.

Avokati u ul. Në sallë ra përsëri qetësi. Anëtarët e trupit gjykues nisën të pëshpëritnin me njëri-tjetrin. Linditën nuk e bindën fjalët e avokatit. Donte që ai të fliste më shumë dhe të jepte argumente bindëse e të detajuara për pafajësinë e saj.

Lindita ishte një grua e zgjuar dhe e gojës. Kishte mbaruar gjimnazin me rezultate shumë të mira. Në shkollë kishte qenë vajzë e shkathët dhe guximtare, ndryshe nga shumica e shoqeve, të cilat kishin frikë dhe turp dhe nuk arrinin të hapnin gojën para njerëzve të tjerë, sepse skuqeshin deri te majat e veshëve. Jeta e saj ishte në rrezik të madh, ndodhej në buzë të greminës. Duhej të mbrohej dhe të kapej pas asaj fije shprese për të mos u rrokullisur poshtë. Toka po i dridhej nën këmbë. Mendoj tre fëmijët. Ishin ende të vegjël dhe kishin nevojë për ndihmën e saj. Nëse do të dënohej me shumë vjet burg, ata do të mbeteshin jetimë me nënën gjallë. I erdhi keq edhe për të shoqin, i cili ishte hequr e tretur edhe më shumë, ca nga puna e rëndë në shtetin grek, ca nga turpi prej saj. Një zë i brendshëm e nxiti të ngrihej e të fliste për atë që kishte ndodhur gjatë atyre tre muajve dhe ia kishte bërë jetën një ferr të vërtetë.

- Me leje! - u dëgjua zëri i saj, që tashmë ishte ngritur më këmbë. - Unë dua të flas! - iu drejtua trupit gjykues. - Dua të mbrohem. Zotërinj të trupit gjykues, ju nuk mund të më dënoni! Nuk mund të më lini në burg! Unë vërtet e bëra vrasjen, nuk e mohoj, por u vetëmbrojta. Kush na

mbron ne gratë kur burra si ai, maniakë seksualë, duan të na përdhunojnë?! Ai u hodh mbi mua si një bishë e vërtetë. M' i vuri thonjtë në fytyrë dhe më kërcënoi se do të më vriste nëse nuk e lija të shfrynte epshin e tij. Atëherë unë e godita me thikën që kisha në dorë. Më thoni, zoti kryetar: çfarë duhej të bëja në ato çaste? Po sikur në vendin tim të kishte qenë gruaja, motra apo vajza juaj?

Kryetari i seancës shqeu sytë. Nuk e kishte pritur një reagim të tillë nga ana e së pandehurës. E kishte nënvlerësuar, e kishte marrë thjesht për një fshatare të rëndomtë, që dinte të mbushte sofrën me fëmijë, t' i shërbente burrit dhe të milte lopën. Hodhi vështrimin nga e pandehura. Sytë e saj ishin ngulur mbi të si dy shigjeta helmuese dhe prisnin përgjigje. Ai vështrim ishte një akuzë shumë e fortë për të dhe sistemin gjyqësor të korruptuar. Vendosi të ndërhynte:

- Ju e kishit paramenduar një veprim të tillë, e pandehur. Ishit pajisur me armë të ftohtë para ngjarjes. Ligji e parashikon këtë dënim dhe unë s' mund të shkel ligjin.

- Me leje! - u hodh një burrë në reshtin e parë.

Kryetari i seancës e vështroi për disa sekonda, pastaj e pyeti:

- Kush jeni ju?

- Unë jam burri i Linditës dhe dua të flas.

- Do ta jap fjalën kur të flasin dëshmitarët! - ia ktheu kryetari.

- Dua të flas tani! Dua të mbroj gruan time!

Kryetari u zu ngushtë. E hodhi vështrimin nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues për të marrë miratimin e tyre. Nuk pati kundërshtim dhe u kthye nga burri i së pandehurës:

- Si ju quajnë, zotëri?
- Sami Fusha.
- Urdhëro, zoti Fusha, fol! Ç'keni për të thënë?
- Unë ju kërkoj që ta lini të lirë gruan time. Ajo e vrau për vetëmbrojtje. Ai deshi ta kapte me zor, ja pse e vrau.
- A ishit në dijëni se Altin Guri e ngacmonte gruan tuaj? Samiu u zu ngushtë. U ndje i turpëruar dhe nuk donte t'i përgjigjej kësaj pyetjeje. Kaluan disa sekonda. Salla priste me kërshtëri përgjigjen e tij. Më në fund, me gjysmë zëri, ai u përgjigj:
- Po, e dija. Më kishte thënë Lindita para ndoshta dy muajve, kur erdha nga Greqia.
- Çfarë biseduat me gruan?
- I thashë që të mos i jepte arsye dhe të shikonte punën e saj.
- Po ajo çfarë ju tha?
- Më tha se kishte frikë.
- A shkuat ju të bisedonit me Altin Gurin?
- Jo. Nuk doja të hapja sherr. Pastaj, edhe kohë nuk kisha, duhej të nisesha për në Greqi, pasi vetëm tri ditë leje kisha marrë nga puna. Unë jam njeri familjar dhe shoh punën time, prandaj ju kërkoj që ta lini të lirë gruan. Ajo është e pafajshme. Unë jam në Greqi dhe gruaja duhet t'i rrisë fëmijët dhe të kujdeset për ta.
- Pas këtyre fjalëve Sami Fusha u ul në vendin e tij. Zemra i rrihte fort. Ndjeu emocione dhe shumë frikë për vendimin që do të merrej.
- Trupi gjykues nuk e merr parasysh deklaratën tuaj. Gruaja juaj ka kryer krim. Ajo ka vrarë me paramendim

shtetasin Altin Guri, - tha kryetari i seancës. Samiu e dëgjoi me zemër të ngrirë. Ndjeu një shtërëngim në gjoks, gati iu mor fryma. Dënimi me burg i së shoqes do të thoshte shkatërrim i familjes së tij. Në sallë u bë përsëri zhurmë. Kryetari i ra përsëri tavolinës me çekiç.

- Ju lutem mbani qetësi! - thirri.

Zërat nisën të shuheshin. Lindita u ngrit përsëri dhe iu drejtua kryetarit të trupit gjykues:

- Zoti kryetar, ju duhet ta merrni parasysh faktin që unë e kreu krimin për vetëmbrojtje. Ka shumë gra që përdhunohen, por nuk flasin se u vjen turp. U vjen turp nga familja, nga fëmijët, nga të afërmit, nga shoqëria, nga të gjithë. Në qoftë se ju jeni shteti, atëherë na mbron! Unë isha e detyruar ta vrisja, përndryshe do t'i nënshtrohesha shtazërisë së tij e t'i lija fëmijët dhe burrin me një mal me turp. Jeta ime, që prej tre muajsh, ishte bërë një ferr i vërtetë. Kisha frikë të shkoja për të mjelë lopën te kasollja. Ai më ndiqte kudo që shkoja. E kisha paralajmëruar disa herë që të më linte të qetë, por ai këmbëngulte. Nëse nuk do të më ngacmonte, nuk kisha pse ta vrisja.

Ajo pushoi për një çast. Mori frymë dhe hodhi sytë nga salla, e cila kishte rënë në një qetësi të thellë. Balli i ishte mbushur me djersë. I fshiu me kurrizin e dorës. Ndihej e dërrmuar.

Pse Lindita Fusha ndodhej në bankën e të akuzuarve? Çfarë krimi kishte kryer ajo? Si kishin rrjedhur ngjarjet?

Altin Guri i kishte kaluar të dyzetat. Ishte i martuar dhe kishte dy fëmijë. Ishte burrë i pashëm, me flokë të zinj e të dendur. E mbante veten dhe ishte qejfli femrash. Veç

këtij huqi kishte qejf edhe gotën e rakisë dhe shpeshherë endej rrugëve të fshatit i dehur, i bërë tapë. Nuk punonte dhe të gjitha hallet e shtëpisë ia kishte lënë së shoqes. Prej disa kohësh kishte zënë një dashnore në fshat. Një grua e pamartuar dhe disi e shkuar në moshë. Pothuaj të gjithë e dinin këtë histori dashurie, por asnjëri nuk fliste hapur. Njerëzit kishin halle të tjera dhe nuk kishin kohë të merreshin me budallallëqet e Altinit. Po dhe i druheshin ndonjë sherri me të. Nuk ishte çudi që dikush ta shihte veten të shtrirë sa gjatë gjerë në mes të rrugës nga ndonjë plumb revoleje apo kallashnikovi. Pas disa kohësh Kristina, kështu quhej e dashura e Altinit, u largua nga fshati. Shkoi në Itali te disa të afërm të saj. Qëllimi i saj ndoshta ishte që të rregullohej në ndonjë punë, qoftë dhe të martohej me ndonjë italian të shkuar në moshë. Kur u largua, nuk i tregoi të vërtetën Altinit, por i tha se do të shkonte si turiste për ndonjë muaj e më pas do të kthehej. Kaluan dy muaj. Altinit i erdhën në vesh fjalët se Kristina nuk do të kthehej në fshat. Dikush tjetër i tha se Kristina ishte rregulluar mirë, madje ishte martuar. Ai u bë si i tërbuar. E ndau mendjen se Kristina nuk do të kthehej dhe nisi të hapte sytë nëpër fshat për ndonjë dashnore tjetër. Mendja i vajti te Lindita, meqë ajo e kishte burrin në Greqi. Lindita i pëlqente, ajo ishte grua e bukur dhe e bëshme. Madje ishte shumë shoqe me Kristinën. Kështu, nisi ta ruante e t'i përgjonte të gjitha lëvizjet pa i rënë në sy. Një ditë u ndeshën ballë për ballë në rrugën kryesore të fshatit.

- Mirëdita, Linda! - e përshëndeti i pari Altini.

- Mirëdita! - ia ktheu ajo dhe vazhdoi rrugën.

- Prit pak, dua të të them diçka.

Lindita mbajti hapat, duke menduar se mund të kishte ndonjë porosi nga e shoqja ose mos ndoshta donte ta pyeste për Kristinën.

- Urdhëro! - i tha dhe e vështroi drejt në sy. Sytë e tij lëvizën me gjallëri dhe ndaluan mbi gjoksin e saj të bëshëm. Ajo e ndjeu atë shikim zhbirues e djallëzor dhe instinktivisht vuri dorën mbi kraharor. - Je shumë e bukur! Ti më pëlqen shumë! - i tha ai duke mos ia ndarë sytë.

Ajo ndjeu grahmën e alkoolit t'i përplasej në fytyrë si një dallgë e fuqishme. Mënjanoi pak kokën për të shmangur atë erë të neveritshme, që doli prej gojës së tij, por më shumë neveri ndjeu nga fjalët e tij.

- S'të vjen turp! Ke grua dhe fëmijë, apo të iku Kristina dhe ke filluar të kërkosh gjetkë?! Gomar! - i tha dhe u largua me të shpejtë, duke e lënë gojëhapur në mes të rrugës si një qen të rrahur.

Ai e vështroi tek largohej me hap të shpejtë.

“Më the ‘gomar’ tani, po kur të të zbus, s’do të më thuash më kështu”, tha me vete ai dhe vuri buzën në gaz.

Linditës nisi t'i rrihte zemra fort. Për një çast pati frikë. Ishte e vetme. Asnjëherë s'i kishte pëlqyer ai tip. Madje, nisi ta urrente kur mori vesh se kishte lidhje me Kristinën. Asaj nuk i kishte thënë gjë, por kohët e fundit ishte ftohur ca dhe u shmangej takimeve me të. Vdekjen e dinte, por që ta ndalonte Altini dhe t'i vardisej në këtë moshë, as që e kishte çuar ndonjëherë nëpër mend. I erdhi rëndë nga vetja. “Kurrë! Sikur ta di se do të vdes, atij pijaneci dhe horri s'i jepem!”, tha me vete dhe e shpejtoi hapin për të arritur sa

më parë në shtëpi. Ditët në vazhdim do të rridhnin gjithë frikë për të. E kishte parë disa herë tek kalonte në rrugë me vështrimin hedhur nga shtëpia e saj. Ai e kishte përgjuar mirë. E dinte orarin kur ajo ngrihej në mëngjes dhe kur shkonte tek ahuri, i cili ishte disa metra larg shtëpisë. Një mëngjes, rreth orës gjashtë, Lindita, si zakonisht, shkoi për të mjelë lopën. Në dorë mbante kovën e qumështit. Sapo hyri brenda, u ndesh ballë për ballë me Altinin. U tremb. Kova i ra nga dora dhe lëshoi një tingull të thatë në dysHEME. Vuri dorën në gjoks. Zemra nisi t'i rrihte me shpejtësi. Filloi të dridhej nga frika dhe doli me vrap nga ahuri. As vetë nuk e mori vesh sesi arriti në shtëpi. Nuk kishte zbardhur ende. U ngjesh pas dritares së kuzhinës. Vuri re se Altini doli jashtë oborrit me të shpejtë. Vazhdonte të dridhej. Fëmijët nuk ishin ngritur ende nga gjumi. Pas pak do të zgjoheshin dhe do të bëheshin gati për në shkollë. Vendosi ta mbante djalin në shtëpi atë ditë. Ndihej e terrorizuar, e pambrojtur. Sa do të donte që i shoqi në ato çaste të ishte aty me të! Donte ta kishte pranë dhe t'ia largonte frikën që i kishte pushtuar gjithë qenien e saj. E dinte se Altini nuk do ta linte të qetë. Si do t'ia bënte? Të lajmëronte të shoqin e t'ia tregonte fije e për pe se ç'kishte ndodhur, apo të mos e shqetësonte fare? Ishte në mëdyshje. Vendosi të mos e shqetësonte. Ditët kalonin dhe frika iu kthye në ankth. E ndryshoi orarin e mjeljes së lopës: nisi ta milte një orë më pas, kur edhe fëmijët çoheshin nga gjumi. Por kjo nuk ishte zgjidhje, sepse një ditë e gjeti Altinin përsëri brenda në ahur. Këtë herë vendosi ta përballonte vetë. Qëndroi te dera dhe i tha:

- Dëgjo: mos hajde më këtu, se do ta pësosh keq!

- Ti do të bëhesh dashnorja ime, përndryshe do ta nxi jetën! - e kërcënoi ai.

- Kurrë! Ti je maskara! Je mësuar me Kristinën ti, por unë nuk jam si ajo!

- Pse nuk do? Unë do të kënaq! Ku e ke burrin, ë? Në Greqi, ë? Por natën të shkon mendja për burrin, apo jo? Bëhu dashnorja ime dhe nuk do të të shkojë më mendja tek ai.

- Zhduku! Unë nuk jam kurvë! Dil nga kasollja dhe mos të të shoh më këtu! - ulëriti ajo dhe nisi të dridhej nga frika.

Ai u afrua. Deshi ta kapte, por ajo doli menjëherë dhe rendi drejt shtëpisë. Hyri brenda dhe mbylli derën. Fëmijët ende flinin. Këtë herë vendosi të lajmëronte të shoqin dhe t'i thoshte për gjendjen e krijuar. Nuk mund të jetonte me frikën se çdo mëngjes Altini do t'i shfaqej si fantazmë në kasollen e lopës. Mendimi se ai do ta kapte dhe do ta përdhunonte e tmerronte. I shkoi ndër mend diçka, por prapë pati frikë. Nuk ishte mësuar me të tilla veprime, por nevoja për vetëmbrojtje ia shtoi edhe më tepër idenë që i lindi aq papritur.

* * *

Janari ishte në të dalë. Ditët ishin të ftohta, por me diell. Mëngjeseve binte brymë, që mbulonte sipërfaqen e tokës, por dhe të jepte përshtypjen e borës së shkrirë. Ishte ora gjashtë e gjysmë kur Lindita doli nga shtëpia për të shkuar tek ahuri, i ndërtuar me blloqe betoni. Çatinë e kishte të mbuluar me fletë eterniti, ndërsa një llamarinë shërbente si

derë. Pak më tutje ndodhej koteci i pulave. Këndesi kishte kohë që këndonte. Lindita kishte veshur një xhup të trashë dhe në dorën e djathtë mbante kovën e bardhë. Shtyu derën me dorën e majtën dhe hyri brenda. Lopa zuri të pëlliste. Ajo shkoi drejt saj, lëshoi kovën në tokë dhe u nis të merrte karrigen e vogël te qoshja e ahurit, por Altini i doli përpara.

- Mirëmëngjesi, Linda! - e përshëndeti.

- Prapë ti këtu?! Ik, largohu! - i tha ajo e frikësuar dhe hodhi vështrimin përçark.

- Jo, këtë herë nuk largohem. Nuk ke nga ia mban, sot do të bëhesh e imja, - i tha ai dhe e kapi për mesi e nisi ta shtrëngonte.

Lindita u tmerrua. E shtyu me sa fuqi pati, por nuk mundi të shkëputej prej tij, pasi ai e shtrëngoi më fort pranë vetes. Ajo ngriti dorën dhe e qëllloi me pëllëmbë në fytyrë.

- Kurvë e mutit! Kujt i qëllon ti?! Do të të mbys! - iu kanos.

- Ik, largohu! - i bërtiti ajo sa mundi.

- Pse nuk do të bëhesh e imja, pse?! - iu hakërrye ai dhe e tundi fort me të dyja duart.

Asaj po i merrej fryma. Jepte e merrte që të çlirohej prej tij, por ishte e pamundur.

- Nuk dua! Kurrë! Më lësho! - thirri ajo duke e parë me neveri.

- Jo, s'të lëshoj!

Për një çast Lindita përfitoi nga rasti, që i pati duart të lira, dhe me shpejtësi futi dorën e djathtë në xhepin e jashtëm të xhupit të madh. Ndërsa ai vazhdonte ta shtrëngonte në fyt, ajo nxori thikën dhe ia nguli në bark.

- Oh, ç'më bëre! - lëshoi ai një ulërimë therëse. Ajo e pa drejt e në sy dhe ia nguli përsëri thikën:

- Na, i poshtë! Na, se ma nxive jetën!

- Ooooh! Oooh! - rënkoj ai.

- Na dhe një tjetër.

Altini iu var në qafë, por Lindita u zbraps dhe ai u plas në tokë. Ajo doli nga ahuri dhe u turr me vrap drejt shtëpisë. Ndaloj te shkallët dhe ktheu kokën pas. Altini doli nga ahuri duke e tërhequr këmbën zvarrë. Dorën e mbante në bark. I rridhte shumë gjak. Lindita zuri të dridhej. Aq shumë e pushtoi frika, sa i shpëtoi thika nga dora. Ngjiti shkallët dhe te dera ktheu përsëri kokën pas: Altini po ecte drejt shtëpisë së tij i kërrusur. Këmbët i shkonin sa majtas-djathtas. Nga larg të jepte përshtypjen e një të dehuri. Duke u dridhur, mori celularin dhe formoi një numër.

Altini e përshkoi atë copë rrugë deri te shtëpia e tij me shpirt ndër dhëmbë. Shtyu derën e jashtme dhe hyri në oborr. Ra përdhe me zhurmë. E shoqja ia behu te dera e shtëpisë. Vuri duart në kokë dhe ulëriti kur pa që i kishte duart të lyera me gjak. Bëri tre-katër metra deri tek ai dhe u mundua ta ndihmonte që të ngrihej. Ai s'mundi.

- Lindita Fusha! - mundi të thoshte ai duke dhënë shpirt me sytë nga e shoqja, pa mundur të jepte shpjegime të tjera.

Mars 2014

Monda

Monda jetonte prej vitesh në Greqi. Kishte ardhur bashkë me familjen e saj sapo u hapën dyert e emigrimit pas rënies së komunizmit. Atëherë ajo ishte e vogël, vetëm dhjetë vjeçe. Pasi u rregulluan me shtëpi dhe babai i saj gjeti një punë, Monda u regjistrua në shkollë. Nuk dinte asnjë fjalë në gjuhën greke, por shpejt e mësoi. Nga natyra ishte vajzë inteligjente. Monda ishte afro njëzet vjeçe kur mbaroi shkollën e mesme. Rrethanat dhe kushtet ekonomike nuk ia lejuan të ndiqte studimet e larta, sepse në familje punonte vetëm babai. Ajo kishte edhe dy vëllezër më të vegjël. Vendosi të kërkonte punë. Rasti e solli që të punonte në një familje greke me gjendje të mirë ekonomike. Thanas quhej burri dhe Marie e shoqja. I kishin kaluar të pesëdhjetat. Kishin dy fëmijë të martuar dhe secili shikonte jetën e vet. Zakonisht të dielave ata shkonin te prindërit dhe drekonin së bashku. Çifti kishte një bar dhe meqenëse nga mëngjesi deri në mbrëmje ndodheshin në lokal, Mondën e punësuan për punët e shtëpisë. Me raste, kur kishin shumë punë, e thërrisnin edhe për t'ua dhënë një dorë ndihmë në lokal. Monda ishte vajzë e bukur. Kishte trup mesatar, pak të

mbushur dhe një fytyrë engjëlllore, që tërhiqte si me magnet vështrimet e meshkujve. Në shkollë ishte dashuruar dy herë, të dy herët me djem grekë, por pa sukses. Ndonjëherë ia vinte fajin racizmit. Ndoshta nuk ishte e prerë për dashuri. Mund të jesh njeri i mirë, por nuk të ecën. Të duket sikur ke me vete një mallkim, që nuk të shqitet e vazhdon të të shoqërojë si një rrugëtar i bezdisshëm në një udhëtim të gjatë e të lodhshëm. Mund të jesh e bukur, por ndonjëherë bukuria nuk pi ujë. Shumë femrave u qëllon të kenë sukses në dashuri. Dashurohen me të parin dhe vazhdojnë me të. Ndërsa disa femra ndërrojnë një, dy apo tre djem dhe nuk arrijnë të krijojnë një lidhje. Më pas bien viktimë e fatit të rastësishëm dhe rrjedha e jetës i merr siç merr uji i lumit një copë dru. Kështu i ndodhi Mondës.

Një sëmundje e keqe e vuri menjëherë poshtë Marien. Asaj iu shpif një tumor në gjoks dhe në krye të vitit vdiq. Thanasi mbeti i ve. Në fillim ishte shumë i dëshpëruar. Vdekja e së shoqes që një goditje tepër e fortë për të. Monda shkonte më shpesh te shtëpia e tij për të larë e pastruar, madje edhe i gatuante. Thanasi i propozoi që ta punësonte në lokalin e tij. Kaluan disa kohë pas vdekjes së të shoqes. Ai nisi ta merrte veten. U bë më i qeshur e më i gjallë. Nuk ishte as i ri, por as nuk mund ta quajë plak. Sapo i kishte mbushur të pesëdhjetë e pesat. I mbetur i ve në atë moshë, mendoi se kishte edhe shumë vite të tjera për të jetuar. I vetëm e kishte të vështirë, ndaj vendosi të martohej ose të jetonte me një grua. Vajza shqiptare, që kishte punësuar, e kishte tërhequr sapo e kishte parë. Sa herë që ajo vinte në shtëpinë e tyre, e vërente me një sy ziliqar si për moshën e

re, ashtu edhe për bukurinë dhe fizikun e saj. Nuk e kishte shfaqur hapur simpatinë që kishte për të nga frika e Maries, e cila, sa vinte Monda, e përpinte me sy. Ai e kishte vënë re xhelozinë e saj prandaj mundohej të hiqej indiferent ndaj vajzës shqiptare. Thanasit i kishin pëlqyer gjithmonë femrat e mbushura dhe me gjoks të madh.

Monda filloi të punonte rregullisht në lokalin e Thanasit. Tetë orë të ditës i kalonte aty, ndërsa më pas shkonte në shtëpinë e tij për t'i bërë ato pak punë ose për t'i gatuar. Thanasi ishte gjallëruar, ishte vazhdimisht në humor të mirë, por edhe kish filluar t'i hidhte shikime provokuese Mondës. Ajo e kishte kapur disa herë mat dhe kishte ndier të dridhura. “Ndoshta tani që është pa grua mendja i vete për femër”, mendonte ajo me vete, por përsëri nuk i shkonte ndër mend të dyshonte. Shikimet dhe ngacmimet dalëngadalë u shtuan. Gjatë kohës së punës në lokal, si edhe në shtëpi, Thanasi bënte sikur e prekte pa dashje në gjoks, në vithe, në krahë, në kurriz, ku të mundte. Ajo shtangej, por prapë ia hidhte fajin rastësisë. Një mbrëmje binte shi. Teksa po mbyllnin lokalin, Thanasi i tha:

- Monda, të të shoqëroj unë për në shtëpi?

- Ajo hezitoi për një çast, po meqë do t'i duhej të bënte një copë rrugë deri te stacioni i autobusit, pranoi.

- Mirë, zoti Thanas, - iu përgjigj.

- Mos më thuaj më “zoti Thanas”, - i tha ai.

- Po si t'ju them? - e pyeti ajo e zënë pak ngushtë.

Thjesht Thanas.

- Nuk mundem! - tha me gjysmë zëri.

Shiu vazhdonte të binte. Ata hipën në makinë dhe u

nisën. Rrugës Thanasi nisi ta ngacmonte. Në fillim i vuri dorën mbi kofshë. Kishte kohë që nuk kishte prekur e provuar femër. Më pas i kaloi dorën mbi gjoks. Monda u drodh. Një valë e ngrohtë e përfshiu dhe fytyra iu skuq nga turpi. U mundua t'ia largonte, por ai i tha:

- Monda, ti je vajzë e zgjuar.

- Të lutem mos, zoti Thanas! - belbëzoi ajo, por çuditërisht ndjeu dëshirë.

- Ti je vajzë shumë e bukur, mua më pëlqen. Ke dëshirë të bëhesh gruaja ime?

Monda shtangu. Çdo gjë mund t'i kishte shkuar ndër mend, por që ai t'i propozonte një gjë të tillë, kurrë!

- Pse nuk flet, apo të vjen turp? Monda heshti. Uli kokën dhe hodhi vështrimin përpara te xhamat e makinës, ku fshirëset lëviznin me shpejtësi teksa pastronin ujën e shiut, që vazhdonte të binte me rrëmbim. Iu rrëqeth trupi, ndoshta edhe nga të ftohtët që i dha ndjesia e shiut.

- Mendohu, këtu jemi. Me mua çdo gjë e ke të siguruar: punën, shtëpinë, lokalin. Unë fëmijët i kam të martuar dhe nuk më shqetësojnë. Ti e di.

- Jo, nuk mundem! - iu përgjigj me vështrimin ngulur mbi xhamin e makinës.

Kur arriti në shtëpi, nuk u ul të hante me njerëzit e familjes. U justifikua se ishte e lodhur dhe shkoi drejt e në dhomën e saj. Atë natë s'e zuri gjumi. Mendime nga më të ndryshme ia cimbisnin trurin e lodhur. Mendoi ta bisedonte me të ëmën, por më pas ndërroi mendje. I erdhi zor. Çfarë do t'i thoshte: që Thanasi e kishte kërkuar për grua?! Ajo do të vinte duart në kokë. Do të shkulte faqet duke i thënë: "Pupu! Thanasi është në moshën

e tyt ati, moj bijë!”. Për afro dy muaj Monda nuk qe as në qiell, as në tokë. Çdo ditë Thanasi i shfaqte dashurinë e tij, sa e bëri të besonte se vërtet ishte i përvëlur për të. U vu mes dy zjarresh. Nga ana e tyre prindërit ia thanë prerë: “Jo! Ai është shumë i madh për ty. Më mirë rri pa martuar se sa të marrësh një plak”, por ajo ishte e lëkundur. Mendonte se mosha po i ikte dhe, po të priste edhe ca, nuk do të martohej kurrë. E ndau mendjen. Vendosi t’i thoshte “po.” Thanasi u bë me fletë. Nuk e zgjati shumë dhe e mori në shtëpi. I tha se hëpërhë do të bashkëjetonin dhe nuk do të vinin kurorë. Ai nuk ishte aq budalla sa të martohej zyrtarisht me të. Martesa do ta bënte Mondën bashkëpronare në pasurinë e tij. Ai nuk donte të rrezikonte. Në mes ishin fëmijët, që gjithsesi nuk do të pranonin kurrë një njerë bashkëpronare me ta. Thanasi nuk e kishte menduar keq, madje dilte i fituar, pasi fuste në krevat një vajzë të re, të freskët dhe të pamartuar më parë. Monda, nga ana e saj, i kishte bërë llogaritë ndryshe. “Po të martohej ose të bashkëjetoj me të, do të kem një shtëpi dhe një punë të siguar. Mund të lind një ose dy fëmijë, të cilëve do t’u siguroj një të ardhme. Është pak i madh në moshë, por punë e madhe! E di që kam një burrë dhe një strehë ku të fus kokën. Më mirë kështu se sa të rri e të pres fatin, që ndoshta nuk më troket kurrë në derë!” Pa u mbushur viti, Monda mbeti shtatzënë. Lindi djalë. E quajtën Kosta. Pasi djali mbushi vitin, e çuan në çerdhe, por meqë punonin deri vonë, menduan të merrnin një grua që t’ua mbante për tri-katër orë. Monda ishte e lëkundur dhe nuk donte, prandaj i tha të shoqit:

- Dëgjo, Thanasi! Më mirë se mamaja ime nuk ma mban asnjëri fëmijë.

Ashtu bënë. Pasi djali dilte nga çerdhja, e mbante Afërdita, mamaja e Mondës. Pas lindjes së djalit marrëdhëniet e Mondës me prindërit e saj sikur u rregulluan disi. Hynin e dilnin rregullisht. Thanasi nuk ishte fort i kënaqur që vjehrra merrej me rritjen e djalit, por nuk deshi t'ia prishte, edhe pse nuk i kishte fort për zemër njerëzit e gruas, madje i përbuzte dhe tallej me ta. Mondës nuk i vinte mirë për këtë sjellje, megjithatë bënte sikur nuk e kuptonte ose nuk e vinte re, kështu bënte një sy qorr e një vesh shurdh. Djali rritej dita-ditës. Gjërat nisën të ndryshonin. Thanasi nuk ishte më aq i dashur dhe i sjellshëm me Mondën. Filluan meritë dhe zënkat e para. Madje, Thanasi kishte nisur të bëhej xheloz. Xhelozia kishte shpërthyer në shpirtin e tij, siç shpërthejnë hithrat qosheve të mureve në stinën e pranverës. Mondës i kishte rënë një nur i bukur. Lajkat e shumta që i drejttoheshin gjatë punës në lokal, ia ngrinin qimet e flokëve përpjetë Thanasit; po i afrohej të gjashtëdhjetave. Kishte frikë dhe ndiente ndryshimin e moshës, madje fuqitë sikur po i shteronin dhe nuk ndihej më ai i pari në krevat. E kontrollonte orë e çast dhe nuk e linte kurrë vetëm në banak. Ajo ndihej keq. Ishte shumë e ofenduar nga sjellja e tij, madje kishte nisur të pendohej për zgjedhjen e gabuar që kishte bërë. Shumë herë shante e mallkonte veten: “Budallaqe! Idiote! Mirë të të bëhet tani! Shkove e u lidhe me një burrë në moshën e babait tënd, sikur u shuan burrat e botës!”

Djali rritej, por jeta e saj sa vinte e vështirësohej më shumë. Madje, ai nisi të vinte dorë mbi të dhe ta dhunonte

rregullisht. Monda ndihej e pafuqishme përballë kësaj egërsie të papritur. Kurrë s'e kishte menduar që ai do të dilte nga binarët dhe do të sillej në atë mënyrë. Shpresonte se ndoshta mund të ishte një periudhë kalimtare e mund të qetësohej dhe të sillej si më parë. Por jo, ai vazhdonte të sillej gjithnjë e më egër. Lindja e djalit i kishte vënë kapak jetës së saj. Ku të shkonte? Ku të mbytej?! Megjithatë, durimi i saj u sos dhe një ditë vendosi t'u tregonte të vërtetën prindërve. Kërkoj ndihmën e tyre. Kush më mirë se ata mund ta ndihmonin në këtë botë të egër dhe mizore?

- Të thamë, moj bijë, por nuk na dëgjove! - i tha i ati me pikëllim.

Më në fund, pas shtatë vjetësh bashkëjetesë, Monda vendosi t'i jepte duart plakut Thanas, tashmë në moshë gjashtëdhjetecavjeçare. Fillimisht ajo mori djalin dhe u strehua te prindërit e saj. Thanasi nuk u ndal me kaq, nisi ta kërcënonte dhe t'i bënte presion. U bë i padurueshëm prandaj Monda ndërroi numrin e celularit. Në njëfarë mënyre sikur e largoi disi. Për fatin e saj të mirë, filloi menjëherë punë në një lokal tjetër. Përvojën e kishte fituar, por Thanasi nuk iu nda. Pas ca kohësh e gjeti ku punonte. I shkoi si klient në lokal dhe filloi ta ofendonte dhe ta shante në sy të të tjerëve.

Ai filloi t'u bënte presion edhe familjarëve të saj. Donte t'i merrte djalin me çdo kusht. Monda e pa veten keq. Vendosi të kthehej në Shqipëri dhe të shpëtonte një herë e mirë prej tij. Kështu bëri. Në Shqipëri u strehua në shtëpinë që e kishin pasur para se të largoheshin për në Greqi. Filloi jetën nga e para. Djalin e regjistroi në klasën e parë.

Thanasi, nëpërmjet miqve të tij shqiptarë, mundi të gjente numrin e celularit të Mondës. Një ditë e merr në telefon dhe i tërbuar nga inati i thotë:

- Do të vij në Shqipëri dhe do të të vras! Nuk lejoj që djali im të mësojë në shkollë shqiptare! Ai është grek dhe shkollën duhet ta bëjë në Greqi!

E lemerisur nga këto kërcënime, Monda paraqiti një padi ndaj Thanasit në gjykatën e Tiranës, e cila nxori urdhrin e mbrojtjes për gruan tridhjetenjëvjeçare. Në vendimin e saj gjykata e urdhëroi shtetasin grek, Thanas Leonidhas, të mos ndërmerre asnjë veprim të dhunshëm ndaj paditëses, Rajmonda Plepi, dhe djalit të saj të mitur, Kosta Leonidhas. Po ashtu ai urdhërohej të mos kërcënonte, ngacmonte apo të taktonte paditësen dhe djalin, madje të mos u afrohej më shumë se njëqind metra. Megjithëse Thanas Leonidhas duhej të ishte i pranishëm në sallën e gjyqit, pasi e kishte marrë me kohë fletëthirrjen, ai nuk u paraqit. Monda ishte më e lumtur që ai nuk ndodhej aty. Ky vendim gjykate sikur e qetësoi Mondën. Tashmë ndihej më e sigurt dhe, kur doli nga salla e gjyqit, dukej e lehtësuar, sikur të kishte larguar nga shpatullat e saj të brishta një barrë të rëndë. “Vërtet Kosta është djali yt, more grek, por në radhë të parë është djali im. Gjuhën shqipe do ta mësojë, se e ka gjuhën e nënës. Do apo nuk do ti, mua aq më bën! Gjuha shqipe ndoshta është më e vjetër se gjuha jote, more i mallkuar, që ma shkatërrove jetën!”, mendonte me vete Monda teksa shtrëngonte dorën e të birit gjashtëvjeçar rrugëve të Tiranës.

Prill 2014

Fshati i krimeve

Fshati Gjonlekaj shtrihej rrëzë një mali të lartë. Ndanë tij kalonte një lumë i vogël me ujë të pastër dhe të ftohtë brisk. Ishte fshat i madh dhe ndahej në dy lagje: lagjja e sipërme dhe ajo e poshtme. Para se të hyje në fshat, ishte dhe një rezervuar i vogël, i bërë që në kohën e komunizmit. Ata pak fshatarë që merreshin me bujqësi, e shfrytëzonin përsëri për vaditjen e arave të tyre. Pjesa më e madhe ishte larguar për në Greqi. Shtëpitë e fshatit, që ishin ngritur që para pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë vjetësh, e që tashmë dukeshin shumë të vjetra, ishin ndërtuar me gurë mali të gdhendur mirë dhe ishin mbuluar me plloça. Duke punuar në emigrim, një pjesë e fshatarëve kishte filluar t'i prishte dhe mbi themelet e tyre ndërtonin shtëpi të reja, me tulla edhe më të larta e më të bukura. Pothuaj të gjithë i bënin me dy apo tri kate, ndryshe nga të vjetrat, që ishin të gjitha njëkatëshe.

Rrugët e fshatit kishin mbetur po ato që kishin qenë në kohën e diktaturës. Asnjë nuk kujtohej të vinte dorë e t'i rregullonte. Në dimër ishin tërë baltë, sepse binte shi, shpeshherë edhe dëborë, ndërsa në verë ishin tërë pluhur.

Ndryshimi i fshatit vihej re te kopshtet para shtëpive, që gjelbëronin nga lulet, frutat apo perimet që kishin mbjellë fshatarët. Ndoshta gjëja më e mirë ishte rrethimi i shtëpive me mure të larta në vend të gardheve me hunj e thupra të kohës së shkuar. Fshati përbëhej nga shumë familje. Në atë fshat jetonte edhe familja e Hasanëve, e cila ishte nga më të hershmet aty. Kishin qenë fis i madh, por tani kishte mbetur vetëm familja e Haki Hasanit me dy djemtë dhe dy vajzat. Ai kishte vdekur prej vitesh, duke e lënë të shoqen, Nuriën, të ve. Dy vajzat ishin martuar me kohë dhe jetonin larg, në fshatra të tjera të krahinës. Djali i madh, Reshati, ishte i martuar dhe kishte tre fëmijë, ndërsa djali i vogël, Selamiu, ishte ende beqar. Hasanët ishin në gjendje të vështirë ekonomike. Që kur kishte vdekur Hakiu, familja kishte marrë tatëpjetën. Reshati kishte rënë në burg në vitin 1997 dhe ishte dënuar me 25 vjet për kryerjen e një krimi të rëndë. Në gjaknxehtësi e sipër kishte vrarë një punonjës të rendit dhe gjykata i kishte dhënë dënimin maksimal. Pas arrestimit i kishte lënë në mëshirë të fatit gruan së bashku me tre fëmijët. Vërtiteshin vetëm me atë copë tokë që kishin, vetëm për të mbajtur shpirtin gjallë. Kur Reshati përfundoi në burg, Selamiut, që ishte 23-vjeç, i ra gjithë barra e familjes. Ai duhej të kujdesej për nënën, që po plakej dhe kohët e fundit ishte sëmurur nga zemra, por edhe për kumatën me fëmijët. Shkoi disa kohë emigrant në Greqi, punoi si argat në tokat e pronarëve grekë, solli pak para dhe me to u ushqyen ca kohë. Mirëpo Selamiu ishte tip i rëndë dhe me huqë. Pinte shumë dhe bënte sherr e shamatë me ata që i dilnin përpara. Shpeshherë e sillnin prej krahësh

në shtëpi. E ëma plakë përditë i lutej: “Martohu, more bir! Krijohu dhe ti familje dhe jeto si gjithë dynjaja”.

“Nuk dua të martohem! Do të kujdesem për fëmijët e Reshatit!”, i përgjigjej ai. Selamiu shkoi edhe nja dy herë të tjera në Greqi. Në fshat u hapën fjalë se kishte bërë një vrasje atje, por nuk dinin të thoshin më shumë. Me sa dukej, ia kishte hedhur paq dhe policia greke nuk kishte mundur të binte në gjurmët e tij. Ngaqë prishte shumë dhe mbante familjen e tij dhe të vëllait, njerëzit thoshin se në Greqi ishte marrë me punë të pista, ndoshta ishin të vërteta ato që thuheshin për të: kishte siguruar ndonjë dorë të mirë me euro, duke u marrë me drogë ose mund të kishte vjedhur ndonjë shtëpi të pasur greke. Fshatarët habiteshin me të, sepse nuk kishte qenë i tillë.

* * *

Selamiu prej kohësh kishte rënë në dashuri. Nuk ishte dashuri adoleshentësh. Ishte dashuri e një njeriu të pjekur. Ishte dashuri e rrezikshme. Ishte si një thikë me dy presa. Ai ishte dhënë pas Dritës, një grua e martuar dhe me një vajzë dyvjeçare, që jetonte me burrin dhe prindërit e tij. I shoqi, Gëzimi, ishte i papunë dhe shkante në Greqi, ku punonte herë në ndërtim e herë në bujqësi, ku të gjente punë. Rrinte nga tre-katër muaj dhe pasi siguronte ca euro, kthehej pranë familjes. Kohët e fundit ai kishte ndryshuar shumë. Pjesën më të madhe të kohës e kalonte te lokali i fshatit duke pirë e luajtur kumar me burrat e tjerë. Drita kishte filluar të shqetësohej. Gëzimi, kur nuk kishte më para për të luajtur e për të pirë, merrte plaçkat dhe sendet e shtëpisë dhe i shiste.

Drita dhe Gëzimi ishin njohur që kur ishin të vegjël. Me kalimin e moshës ishin dashuruar e më pas ishin martuar. Në fillim shkonin mirë, po kur lindën këto probleme gjërat nisën të ndryshonin. Drita filloi ta urrente përherë e më shumë kur ai kthehej duarbosh në shtëpi, për më tepër i bërë xurxull. Mundohej të mbante familjen bashkë me vjehrrën dhe vjehrrin duke u kujdesur për atë pak copë tokë që kishin, ku mbillnin perimet më kryesore. Ajo lodhej së tepërmi, por s'kishte ç'të bënte. Ishte e re dhe e bukur. Kishte nevojë për dashurinë dhe përkujdesjen e të shoqit, por në fakt ndihej e lënë pas dore prej tij. Këtë rast e shfrytëzoi Selamiu, i cili iu vardis Dritës. Kur Gëzimi nisi të shkonte emigrant, ajo filloi të takohej me Selamiun natën në shtëpinë e saj kur pleqtë binin në gjumë. Dashuria e tyre ra në sy në fshat. Banorët nisën të pëshpëritnin, por atyre aq u bënte, sidomos Selamiut. Ai u dashurua marrëzisht me Dritën, ndoshta ngaqë për të ishte dashuria e parë dhe e vërtetë. Ai i kishte mbushur tridhjetë e gjashtë vjeç, ndërsa Drita ishte dhjetë vjet më e vogël. Pak kohë pasi ata u lidhën me njëri-tjetrin Drita mbeti shtatzënë dhe lindi djalë. Dashurinë me Selamiun e vazhdoi edhe pas lindjes. Pas pak kohësh fjalët e pëshpëritura ranë në veshin e burrit të saj. Ai nuk e vrau shumë mendjen që e shoqja dita-ditës i vinte brirë. Vazhdonte jetën e tij të zakonshme me gotën e alkoolit, kumarin ose shkonte në Greqi. Indiferenca e tij lidhej me frikën që kishte nga Reshati, pasi ky i fundit ishte i dhunshëm. Kur Drita lindi djalin, Selamiu e pyeti:

- Djalin e ke me mua apo me tët shoq?

- E kam me tim shoq, - iu përgjigj ajo.

- Nuk e besoj. Djalin e ke me mua. Unë jam i sigurt, - i tha i vendosur ai.

- As mos të të shkojë nëpër mend, djali nuk është i yti, - ia ktheu edhe më e vendosur ajo.

Selamiu nuk e besoi. Ai ishte plotësisht i bindur se fëmija ishte i tij. Pas disa kohësh, kur djali filloi të rritej, ai i kërkoi Dritës që të ndahej nga i shoqi.

- Lëre Gëzimin dhe martohu me mua, - i tha një ditë.

- Nuk mundem! Kam fëmijët dhe s'dua t'i lë, - iu përgjigj ajo me pikëllim.

- Unë të marr me gjithë fëmijë, - i tha ai.

- Të lutem, Selami, nuk mundem!

- Ti më pate premtuar se do ta lije burrin dhe do të martohesh me mua.

- Të kam premtuar, por jam penduar. Nuk dua ta shkatërroj familjen!

- Për çfarë familjeje më flet?! Një fëmijë e ke me të dhe një fëmijë e ke me mua. Familje i thua ti kësaj?!

- Ta kam thënë edhe herë të tjera që djali nuk është yti, por i Gëzimit, - deshi të mbrohej ajo.

Kur dëgjoi emrin e tij, Selamiu u nevrikos dhe e kërcënoi:

- O do ta lësh atë budallain e do të bëhesh e imja, o rrugë tjetër s'ka! Si pa dashje ai çoi dorën te këmba e djathtë, ku futur në çorape mbante një thikë të mprehur mirë. Dritën e pushtoi një frikë që e tmerroi të gjithën. Përballë këtij propozimi, sa të guximshëm dhe aq të pazakontë, ajo u ndje e dobët. Iu duk vetja si lëvozhgë arre, që kolovitet në ujë dhe herë shkon nga njëra anë e herë nga ana tjetër. Ishte në mëdyshje. Burrin kishte filluar ta urrente. Selamiun e

dashuronte shumë, por kishte frikë nga burri. Kaluan disa kohë. Ajo nisi ta ndiente shumë presionin e Selamiut. Nisi t' u shmangej takimeve dhe telefonatave me të. Pavendosmëria e saj nisi ta mërziste shumë Selamiun dhe kështu shkante në lokalin e fshatit dhe pinte derisa bëhej dru fare. Në shtëpi e çonin shokët të kapur prej krahësh. Kur i dilte pija, mendjen e kishte vetëm tek ajo. Një ditë Selamiu u përball me Dritën në rrugën kryesore të fshatit. Ajo u tremb, por nuk kishte nga t' ia mbante. Ai ishte i pirë. Sytë i kishte të kuq dhe të fryrë. E zuri nga fyti dhe duke iu marrë goja i tha:

- Lëre atë budallain dhe hajde me mua.

- Jo, nuk e lë, - ia ktheu ajo e vendosur.

I inatosur, ai e goditi me pëllëmbë me sa fuqi kishte. Ajo desh ra, por u mbajt te krahu i tij. Pastaj u mundua të shkëputej prej thonjve të tij, që e shtrëngonin si darë, por nuk mundi. Zuri të qante me ngashërim dhe mes dënësave iu lut:

- Më lësho, të lutem, se më mbyte.

- Nuk të lëshoj. Do të të mbys. Do të të vras. Në qoftë se nuk bëhesh e imja, do të të vras ty dhe atë burrin tënd trap! I thuaj që dua ta takoj. Dua të flas me të. Dua që të jesh vetëm e imja, more vesh?! - i bërtiti me sa kishte në kokë dhe ia hoqi duart nga fyti.

Ajo mezi mbushej me frymë. Nga shtrëngimi sytë i kishte të kuq dhe lotët i rridhnin çurg faqeve të ndezura. Zemra i rrihte fort.

- Po atij dajës tënd kush i ka thënë?! - iu kërcënua ai.

- Cilit dajë? Unë s' di gjë, - u përgjigj ajo.

- Atij de, që më goditi në mes të klubit, - i tha ai dhe e shtrëngoi përsëri për fyti. Drita e dinte shumë mirë se ç'kishte ndodhur disa ditë më parë, por luajti rolin e së paditurës. U mundua t'i shmangej këtij diskutimi.

- Të lutem, Selami, mos më mundo! Nuk mund të martohem me ty. Unë e kam një burrë, - iu lut ajo dhe iu mbështet në gjoks.

Ai u zbut disi dhe zuri t'i ledhatonte flokët e shpupuritur. Më pas i kaloi dorën mbi fytyrë dhe ndjeu lotët e saj të nxehtë t'i njomnin gishtat. U mundua t'ia fshinte me kurrizin e dorës, por ata vazhdonin të pikonin si pikat e shiut nga streha e çatisë.

- Mos qaj. Unë të dua, Drita! Po çmendem fare! Mendjen e kam veç tek ti! - i tha ai dhe vazhdoi ta ledhatonte

Ajo ngriti kokën, e pa drejt e në sy dhe me zë të dobët i tha:

- Edhe unë të dua, por ti duhet të më kuptosh. Nuk mundem, Selami. Nuk dua që të bëhemi gazi i botës.

- Nuk dua t'ia di se ç'thotë bota. Dua që ti të jesh e imja, - ia ktheu ai me zë të lartë dhe ia kapi fytyrën me të dyja duart e nisi ta puthte fort në sy, në qafë, në buzë.

Ajo përfitoi nga kjo dobësi dhe u shkëput prej duarve të tij. Frika ia mbështolli zemrën siç vishet me akull një send i lënë në frigorifer. Iku me vrap pa e kthyer kokën, duke e lënë Selamiun në mes të rrugës, në errësirën që kishte filluar të binte mbi fshat. Sapo mbërriti në shtëpi, mori të motrën në telefon dhe i tha se duhej të bisedonte me të patjetër. E lanë që të takoheshin të nesërmen. Atë natë Drita nuk vuri gjumë në sy. U përpëliti në shtrat si peshku në skarë. Me

ëndrra të frikshme e kaloi pothuaj gjithë natën, deri në të gdhirë, kur e kapiti gjumi. Të nesërmen dy motrat u takuan me njëra-tjetrën. Bukuria, më e vogël se Drita në moshë, ishte e martuar po në fshat dhe jetonte me burrin dhe me dy fëmijët. Ishte grua e bukur, me trup të hollë e të gjatë dhe flokë të zinj, që i binin mbi supe e i jepnin më shumë hijeshi pamjes së saj.

- Si e ke hallin? - e pyeti të motrën me një frymë.

- Lëre, mos e pyet! Keq! Shumë keq!

- Pse? Çfarë ka ndodhur?

- Selamiu më kërcënoi. “Do të vras, - më tha, - po s’u bëre e imja!” - i shpjegoi Drita me një fije zëri duke u dridhur.

Bukuria i hodhi një vështrim së motrës. Iu dhimbs. Ishte hequr në fytyrë dhe sytë i kishte të lodhur e të futur brenda zgavrave. Ndoshta edhe pagjumësia e një nate më parë kishte ndikuar në pamjen e saj.

- Ashtu?! Po ti ke frikë? - e pyeti e shqetësuar.

- Po. Kam shumë frikë. Ai është i krisur. Kam një parandjenjë të keqe. Ndiej një boshllëk në vetvete dhe një përzierje në stomak. Dua të lajmëroj policinë, por s’kam guxim.

- Budallaqe! Mos e lajmëro policinë, ndoshta të bën presion që të të bindë. Nuk ma merr mendja se e bën një budallallëk të tillë.

- Nuk di si t’ia bëj. Kam frikë, - përsëriti Drita e shqetësuar.

- Mos ki frikë, - i dha kurajë Bukuria së motrës. - Ai të do dhe nuk mund të të vrasë, por ti nuk duhet ta prishësh familjen dhe t’i bindesh atij.

- Ti thua kështu, sepse nuk e njeh, por ai s'ta bën të gjatë. Më tmerron kur më tregon thikën, që e mban të fshehur në çorape. Atij nuk i bën syri tërr. Herë-herë më thotë se puna është sa të vrasësh të parin. Më pas nuk të bën më përshtypje. Me sa di unë, është ngatërruar edhe me një vrasje para pak kohësh. Mua nuk më ka thënë, por e kam kuptuar vetë.

Për t'ia larguar vëmendjen, Bukuria ndërroi bisedë.

- Po ky gomari çfarë thotë? - e pyeti për të shoqin.

- Gëzimi ka frikë. Selamiu i ka kërkuar disa herë takim, por ai nuk i del. Mbrëmë më tha t'i thosha se donte ta takonte. Çfarë t'i bëj?! Kam burrë hajvan, që veç të luajë kumar e të pijë di!

- Fati yt i keq që ke një burrë të tillë! Më mirë të mos kesh fare! Më mirë ta lësh, po çfarë t'u bësh fëmijëve, se i lë rrugëve! - i qau hallin e motra.

- Eh, moj motër, ma nxiu jetën idioti!

- Ti duhet t'i japësh fund aventurës me Selamiun. I tërë fshati po flet për ju të dy, sidomos pas asaj që ndodhi në klub mes dajës së Gëzimit dhe atij.

- Ma përmendi dje, por unë iu shmanga. Po edhe dajës ç'iu desh të fuste hundët në këtë mesele! Kam frikë! "Do ta vras edhe dajën", më tha.

- Unë kam dëgjuar diçka, por nuk e di mirë. Si është puna mes dajës dhe atij?

- Po ja, daja e ka goditur me pëllëmbë Selamiun në mes të klubit dhe ai është bërë si i tërbuar tani. Me sa kuptova, ndihet i turpëruar, sepse aty kishin qenë gjithë ata burra të fshatit.

- Bobo, ç'paska bërë ditëziu! Kur ka ndodhur kjo?

- Para një jave. Daja i Gëzimit e ka kërcënuar dhe i ka thënë që të mos më ngacmojë më, se përndryshe do ta ketë punën keq.

- Po ti ke folur me dajën?

- Po. Erdhi tek unë para se të ndodhte shërri mes tyre.

- E ç'të tha?

- Më pyeti se si qëndronte puna me Selamiun. Ai dinte diçka, sepse ia kishte treguar e shoqja, por unë e gënjeva. I thashë se më ngacmon dhe nuk më lë rehat.

- Po të them përsëri: duhet të vendosësh një herë e mirë. Duhet t'u japësh fund dashuriçkave me të dhe të shikosh burrin dhe fëmijët! - e këshilloi e motra.

- S'di ç'të bëj! Ai më kërcënoi dhe më tha se do të më vrasë po s'u bëra gruaja e tij. Ngul këmbë te djali. Mendon se është i tij.

- Ti je e sigurt që djalin s'e ke me të?

- Jam shumë e sigurt. Djalin e kam me Gëzimin. Ai të thotë e të mendojë si të dojë, fëmijët janë motër e vëlla prej nëne e babe, - i tha e vendosur së motrës.

- Largohu prej tij. Mos e tako dhe mos ia hap celularin.

- Kam frikë se do të vijë e do të trokasë në shtëpi. Kot nuk kërkon ta takojë Gëzimin. Ky ka frikë dhe më thotë se ç'punë ka ai me të. S'di si të bëj! Jam e sigurt se do t'i thotë të më lërë mua. Ai është shumë i vendosur që të martohet me mua.

- Sa budalla! Në vend që të martohet me ndonjë vajzë të re, kërkon të martohet me ty, që je e martuar dhe me fëmijë! Këta burrat e sotëm, nuk e di, o janë budallenj, o

janë të luajtur fare. - Drita mblodhi supet. - Nuk e di. Ajo që di të them është se më habit vendosmëria e tij, - tha duke e vështruar të motrën drejt e në sy.

- Jam në hall, nuk e di sesi do të dal nga kjo gjendje!

Bukuria u largua për në shtëpi me mendje të prishur. Biseda me të motrën e tronditi shumë dhe i futi një lloj frike dhe ankthi të pashpjegueshëm. Zemra i ndillte keq dhe të gjithë rrugën deri në shtëpi e bëri duke iu lutur Zotit.

* * *

Në fshatin Gjonlekaj para më shumë se 17 vjetësh kishte ndodhur një krim vërtet i tmerrshëm. Kurrë më parë nuk ishte parë e dëgjuar një mynxyrë e tillë. Nuria, bashkë me të shoqin, Sabri Gërxhalliun, kishin vrarë një djalë të ri. Viktima ishte nipi i Sabriut. E tmerrshme! Po pse kishte ndodhur ky krim i llahtarshëm? Cilat kishin qenë arsyet e kësaj ngjarjeje makabre? Çifti në fjalë jetonte në fshat dhe kishte dy vajza dhe dy djem. Të katër fëmijët ishin të martuar. Dy prej tyre jetonin në qytet, ndërsa dy të tjerët kishin emigruar në shtetin fqinj. Pas rënies së komunizmit Qemali, vëllai i Sabriut, u shpërngul nga fshati dhe shkoi të jetonte në Tiranë bashkë me të shoqen dhe djalin e vogël, ende i pamartuar. Ai kishte edhe dy vajza, të cilat jetonin me familjet e tyre në Tiranë. Ndoshta kjo ishte arsyeja që e shtyu të largohej nga fshati. Djali i tij, Skënderi, ishte shumë i shkathët dhe i punës. Kishte filluar të merrej me ndërtime dhe kishte krijuar një firmë të tijën. Punët po i shkonin mirë. I dhënë shumë pas saj, nuk kishte mundur të martohej. Nuk

e vriste fare mendjen. Kur binte fjala, prindërve u thoshte i qetë e me buzën në gaz: “Pse shqetësoheni? Ka kohë që të martohem dhe të krijoj familje”. Mirëpo Sabriu dhe e shoqja u bënë ziliqarë dhe u vinte të pëlçisnin që asnjëri prej fëmijëve të tyre nuk u tregua i shkathët dhe i zoti si i kushëriri. Madje, ata kishin frikë se, po të fuqizohej më tepër, mund t’u sillte probleme me pronat që kishin në fshat. Duhej bërë diçka, që Skënderi të mos u hapte probleme. Nuria i propozoi një ditë një plan të shoqit. “E ftojme një natë për darkë me shkakun se do t’i gjejmë një nuse dhe më pas e vrasim”. Sabriu nuk desh në fillim. Fjalët e së shoqes iu dukën jonormale. Nuria, bëri çmos derisa gjeti mënyrën për t’i hedhur trutë e gomarit të shoqit. Skënderi u nis me gëzim nga Tirana për në fshat te xhaxhai. Propozimi i tij dhe i xhaxheshës iu duk interesant. Ndoshta kishte ardhur koha që edhe ai të martohej e të mblidhej në shtëpi si gjithë të tjerët. Në fshat arriti sapo kishte rënë mbrëmja. Sa vuri këmbën në pragun e shtëpisë së xhaxhait, Nuria, që e priste pas dere, e goditi me sëpatë në kokë dhe ia çau kafkën më dysh. Skënderi mbeti i vdekur në vend. Sabriu humbi ndjenjat dhe u plas në tokë kur pa skenën e llahtarshme. Pas disa minutash e pa veten të lagur nga uji që e shoqja i hidhte për ta sjellë në vete. Fjalët e para që dëgjoji ishin:

- Çohu, more hajvan, dhe më ndihmo ta heqim trupin e këtij të flamosuri!

Sabriu ishte hutuar fare dhe dridhej sikur ta kishin zënë ethet. E shoqja i ulëriti në fytyrë dhe e shkundi nga supet:

- Nxito, të them! Ç’më rri ashtu si tutkun.

Ai filloi të bënte ato që i tha e shoqja. Për pak sa nuk shkau mbi gjakun e përhapur në dysheme. Shkoi në dhomë dhe mori qilimin e madh. E mbështollën trupin pa jetë të Skënderit dhe e lidhën mirë. Rreth orës dy pas mesnate, me trupin e të ndjerit njëri në një anë e tjetri në anën tjetër, dolën me kujdes nga shtëpia dhe nxituan për te rezervuari në të dalë të fshatit. Nuk i pa njeri. E hodhën kufomën në rezervuar. U kthyen me të shpejtë në shtëpinë e tyre. Pastruan, me ujë të bollshëm, vendin e krimit nga njollat e gjakut, për të zhdukur gjurmët. Nga ky çast Skënderi rezultoi i humbur. Hamendësimet ishin nga më të ndryshmet. Dikush thoshte se ishte larguar nga Shqipëria për arsye të borxheve të shumta që kishte marrë për ndërtimin e pallatit, dikush tjetër ngrinte hipotezën se ishte marrë peng dhe pengmarrësit do ta lëshonin vetëm kur ai të shlyente borxhet. Asnjëri nuk e gjente dot shkakun e vërtetë të zhdukjes së tij. Kujt i shkonte ndër mend se ishte vrarë nga xhaxhai dhe e shoqja e tij? Ndërkohë policia ishte në kërkim të vazhdueshëm. Pas tre muajsh misteri i zhdukjes së Skënderit u zbulua. Policia gjeti trupin e tij në bregun e rezervuarit. Dyshimet ranë menjëherë mbi Sabri Gërzhalliun dhe të shoqen. Ata e pranuan krimin e kryer dhe drejtësia i dënoi me nga 15 vjet burg. Ky krim i padëgjuar tronditi nga themelet fshatin Gjonlekaj e sidomos fëmijët e çiftit vrasës, të cilët i braktisën prindërit dhe nuk pyetën ndonjëherë për ta gjatë kohës së kryerjes së dënimit. Të njëjtin qëndrim mbajtën edhe fshatarët. Pasi e kryen dënimin deri në ditën e fundit, burrë e grua u kthyen në fshat. Përpiqeshin të vazhdonin jetën e tyre. Mendonin se kishin ende jetë përpara dhe duhej

ta jetonin, edhe pse e dinin se nuk ishte e lehtë. Sabriu ishte rreth të gjashtëdhjetave, ndërsa Nuria ishte gjashtë vjet më e re. Në fshat Sabriu kishte të motrën, nipërit dhe mbesat. Filloi të afrohej me të motrën. Sabriu ishte daja i Gëzimit, burrit të Dritës. Nuries i ranë në vesh fjalët që pëshpëriteshin lart e poshtë për dashurinë e Selamiut me Dritën. Ajo menjëherë ia tha Sabriut, i cili u bë si i xhindosur kur mori vesh këtë turp, siç e quajti ai. Thirri Dritën dhe e pyeti gjerë e gjatë për ato që kishte dëgjuar, madje i bëri presion që të hiqte dorë. Ajo e mohoi lidhjen jashtëmartesore me Selamiun. I tha se shpesh i binte më qafë. Kaq deshi Sabriu. Burgu e kishte shndërruar në tjetër njeri dhe nuk ia përtonte aspak sherrit. Një ditë e ruajti Selamiun kur hyri në klubin e fshatit dhe i vajti te tavolina.

- Dua të bisedoj me ty, - i tha ashpër pa e përshëndetur fare.

Selamiu u shtang kur dëgjoji këto fjalë. Në dorë kishte gotën e rakisë. Ende nuk e kishte vënë në buzë.

- Për çfarë do të bisedosh me mua? - e pyeti me një vështrim mospërfillës.

- Dëgjo, djalë i mbarë! Janë hapur fjalë për ty dhe nusen e tim nipi. Po të paralajmëroj të mos e ngacmosh më. Ajo është e martuar dhe ka burrë e fëmijë. Mos i bjer më qafë, përndryshe do ta pësosh keq! Kaq di të them unë!

Selamiun e pushtoi frika. Zemra i ndolli keq. Nuk donte të përplasej me Sabriun. Ia njihte kokën. “Ky, ashtu siç vrau nipin e tij, mund të më vrasë edhe mua”, tha me vete dhe mendoi t’i shmangej këtij diskutimi. U ngrit më këmbë dhe mori të ikte, por Sabriu e mbërtheu nga fyti.

- Nuk të lë të ikësh pa e sqaruar këtë muhabet.

Selamiu ruajti gjakftohtësinë. Ia largoi dorën dhe i tha:

- Unë nuk e kam ngacmuar nusen e nipit tënd.

- Ajo më tha që ti i bie më qafë, e ngacmon dhe s'ë lë rehat, - i bërtiti Sabriu. Ulërima e tij bëri që të gjithë sa ishin aty të kthenin kokën. Selamiu u rëndua nga vështimet e tyre. Fytyra iu bë flakë e kuqe. Mendoi t'ia përplaste në fytyrë të vërtetën dhe të mos e linte që t'i dërdëlliste broçkulla.

- Dëgjo këtu, o Sabri! Unë nusen e nipit tënd e kam dashnore që prej pesë vjetësh dhe dua ta marr për grua. Djalin e ka me mua dhe jo me atë gomarin, nipin tënd të fam...

Nuk arriti ta mbaronte fjalën, sepse Sabriu e goditi me pëllëmbë në fytyrë me sa i hëngri krahu. Selamiu desh ra, por u mbajti pas karriges. E shtyu Sabriun dhe doli menjëherë nga klubi. Frymën e mbajti drejt e në shtëpi. Duke ecur rrugicave të fshatit u betua me vete: “Kam për ta lëruar nënën, o Sabri Gërxhalliu! Do të të vras, o kërmë! E di që do të kalbem në burg, por ty do të të zhduk nga faqja e dheut!”. Poshtërimi para burrave të fshatit e bëri si të tërbuar. Sedra iu lëndua aq shumë, sa u pendua që nuk ia ktheu borxhin e asaj pëllëmbë, që vazhdonte t'i digjte ende. Kur arriti në shtëpi, ora po shkonte dy e drekës. E ëma po e priste.

- Ku ishe, o bir? - e pyeti.

- Në fshat, - iu përgjigj ai.

- Do të hash?

Ai nuk foli, por hoqi pallton dhe u ul në divan.

- Të kam bërë byrek, e ke mbi tavolinë, - i tha ajo.

- Nuk më hahet tani, - ia ktheu dhe u ngrit vrik nga divani.

Doli menjëherë, madje nuk e veshi as pallton.

- Ku shkon? - e pyeti e merakosur ajo kur pa që doli rrëmbimthi, pa vënë gjë në gojë. Ai nuk i ktheu përgjigje. U kthye pas disa minutash. Ishte i prishur në fytyrë. Veshi pallton dhe duke dalë i tha së ëmës:

- Do të dal pak. Nuk vonohem.

- Mirë, o bir, po kur të vish, ktheu nga doktoresha dhe më merr ilaçet e tensionit, se më janë mbaruar.

- Mirë, mirë, i marr unë, - i tha dhe u largua menjëherë.

E ëma e ndoqi me sy, pa kuptuar ç'po ndodhte me të birin. Shpresoi që ai të kthehej shpejt dhe t'i sillte ilaçet. Kohët e fundit ishte rënduar shumë. Vdekja e burrit, para pak kohësh dhe vitet e djalit të madh në burg kishin ndikuar shumë në gjendjen e saj shëndetësore.

* * *

Atë mëngjes Selamiu u ngrit me humor të keq. Natën kishte parë disa ëndrra të frikshme me gjarpërinj, zjarre dhe koka njerëzish zhytur në baltë dhe me flokë të rënë. “T’ëmën! Çfarë do të më dalë me këto të flamosura ëndrra?!”, tha me vete dhe zemra i ndolli keq. Nga pleqtë kishte dëgjuar se ëndrra të tilla sillnin vdekje ose fatkeqësi. Në një ëndërr tjetër kishte parë Dritën me fustan të bardhë nusërie, por të grisur dhe të bërë me baltë në fund. Kësaj ëndërr nuk dinte si t’ia jepte shpjegimin. U mundua ta largonte mendjen prej tyre. Kishte kaluar afro një javë nga ngjarja e ndodhur në

klubin e fshatit. Gjatë kësaj jave Selamiu nuk kishte qenë i qetë. Pëllëmba e Sabri Gërxfhalliut i digjte ende. Vështrimet e burrave të fshatit, në çastin e goditjes, i ishin dukur si shigjeta dhe vazhdonin ta shponin drejt e në zemër. Nuk donte të humbte kohë. Si u vesh, doli nga shtëpia dhe u drejtua për nga lokali. Porositi një gotë raki dhe, pasi e rrëkëlleu menjëherë, doli nxitimthi jashtë dhe mori rrugën kryesore të fshatit. Gjatë ecjes nxori celularin nga xhepi i palltos, gjeti numrin e Dritës dhe shtypi butonin e thirrjes. Priti disa sekonda. Ato iu dukën shumë të gjata. Ajo nuk po përgjigjej. Ankthi po e torturonte. Më në fund zilja u ndërpre dhe ai foli me të shpejtë:

- Alo, Drita! Ç'bën? Ku je?

- Hiç! Ç'të bëj?! - u përgjigj ftohtë ajo dhe me zë të ulët.

Celularin e mbante gjithmonë me vete në xhepin e pantallonave. Kur tringëlliu zilja, ajo pa numrin e tij dhe nuk deshi të përgjigjej. Ishte në aneksin e kuzhinës dhe po përgatiste diçka. I shoqi, ulur në divan, po pinte kafënë e mëngjesit duke e shoqëruar me një gotë raki, ndërsa fëmijët po hanin. Doli menjëherë nga aneksi dhe shkoi në dhomën e gjumit. I shoqi e shoqëroi me sy, pa i bërë zë. Ajo mbylli derën dhe u ul në cepin e krevatit. Dukej e lodhur. Nuk ishte zgjuar mirë atë mëngjes. Edhe ajo natën e kishte kaluar me ëndrra. Zbrazëtia në stomak sa vinte i bëhej më e thellë.

- Po të pyes ku je, - i foli Selamiu me ton të ashpër.

- Në shtëpi, - iu përgjigj menjëherë ajo kur dëgjoi që zëri nga ana tjetër e celularit i erdhi i fortë. Drita e kishte shumë frikë Selamiun.

- Dua të takohemi! Dua t'i sqarojmë një herë e mirë të gjitha muhabetet!

- Nuk mundem, Selami! Nuk dua të të takoj më, - iu përgjigj me zë të akullt dhe zemra nisi t'i rrihte nga frika.

- Moj, dëgjon ti apo jo?! Dua të takohemi menjëherë! - ulëriu ai.

- Të lutem, Selami, më lër rehat në jetën time. Nuk dua të shkatërroj familjen, më vjen keq për fëmijët, - i tha ajo me zë të ulët që të mos e dëgjonte i shoqi.

Nuk kishte frikë prej tij, por sidoqoftë ishte mirë që të mos e lëndonte më shumë. Ajo kishte nisur të reflektonte ndaj veprimeve të saj, sidomos pas ndërhyrjes së dajës me të shoqen. Presioni i tyre e kishte kthyer me këmbë në tokë.

- Drita, ti e di se sa të dua. Unë ose të marr ty, ose rrugë tjetër nuk kam. Nuk do të të lejoj të jetosh e qetë, në qoftë se nuk bëhesh gruaja ime.

- Më lër të qetë, mos më bjer më qafë.

- Ti më pate premtuar se do ta lije burrin dhe do të martoheshim bashkë, apo jo?

- Të kam premtuar, por ndërrova mendje, - ia ktheu ftohë ajo.

- Çfarë the?! Ashtu? Ke ndërruar mendje? Do të vazhdosh jetën me atë budallain? Do ta shohësh! Do t'ju vras të gjithëve! - ulëriti ai.

Ajo i mbylli celularin dhe u plas mbi krevat sa gjatë gjerë. Nisi të qante me ngashërim. Frika, ankthi, turpi ishin mbledhur në qenien e saj të brishtë dhe po ia merrnin frymën. Pas pak ndjeu derën që u hap. Ngriti kokën dhe pa se ishte i shoqi.

- Çfarë ke? - e pyeti ai i tronditur kur e pa të shkrehur në dënësë.

Drita nuk foli. Me kurrizin e dorës u mundua të fshinte lotët, që vazhdonin t'i rridhnin mbi faqet e nxehta. Ai iu afrua dhe e përkëdheli mbi flokët e shkalafitur. U mundua t'ia rregullonte. Ajo u ngrit vrik dhe e pushtoi me sa fuqi kishte. E mbuloi me të puthura, ndërsa lotët vazhdonin t'i rridhnin çurg. Në mes të ngashërimeve ajo i tha:

- Më fal, Gëzim, që të kam tradhtuar! Më fal! Të premtoj që nuk do të të tradhtoj më, do të jem vetëm jotja! Nuk dua ta shkatërrojmë familjen!

Ai nuk foli. Fjalët e saj i therën në zemër. I erdhi keq për të shoqen dhe turp nga vetja, që nuk kishte mundur të ishte një burrë i vërtetë për gruan dhe një baba i devotshëm për fëmijët. E urreu veten që ishte dashuruar vetëm me gotën e rakisë dhe kumarin. E kuptoi se ishte shkaktari kryesor i gjithë asaj tragjedie familjare që po kalonte.

- Ta kam falur, - i tha ai dhe filloi ta puthte me zjarr si dikur.

Vazhduan të putheshin e të përqafoheshin me njëri-tjetrin deri në çastin që dëgjuan të bërtiturat e fëmijëve dhe dera e dhomës së tyre u hap me vrull. Ata ngrinë: para tyre ndodhej Selamiu me pushkë në dorë. Drita ulëriti me sa pati në kokë:

- Mos, Selami! Mos na vrit! Të!..., - por nuk arriti ta mbaronte fjalën, sepse Selamiu, me sy të shqyer nga skena që pa, e shkrepri pushkën mbi ta. Qëlloi disa herë, derisa u bind që i vrau të dy. Doli me rrëmbim në mes të të qarave dhe ulërimave therëse të fëmijëve dhe u nis për te klubi i fshatit. Ecte shpejt. Në mendje kishte vetëm qëllimin e

radhës. Nuk ndiente keqardhje për veprimin e kryer pak më parë. Një pjesë e qenies së tij u çlirua nga makthi që e kishte përfshirë kohët e fundit. “Nuk deshe të martoheshe me mua! Nuk deshe të ishe e imja dhe më mashtrove! Të desha më shumë se çdo gjë tjetër në botë, por ti nuk pranove!” tha me vete ndërsa ecte si i çakërdisur duke shtrënguar pushkën nën kapotë. Përhëndetjes së disa fshatarëve, që hasi rrugës, iu përgjigj vetëm me një lëvizje të kokës. Hyri në klub dhe porositi një raki. Banakieri ia mbushi menjëherë dhe duke ia zgjatur gotën e pyeti:

- Si je, o Selami? Sikur s'të shoh mirë, mos ke ndonjë hall?

- Eeh! - ia bëri ai duke tundur kokën. - Kjo botë e poshtër është e mbushur vetëm me halle. Mjerë atij që i bien këto të flamosura!

E rrëkëlleu gotën me një frymë dhe e përplasi mbi banak. Disa nga klientët kthyen kokën drejt tij.

- Ma mbush edhe me një tjetër, - i tha banakierit dhe futi dorën në xhepin e pantallonave e nxori një kartëmonedhë për të paguar.

- Po mjaft, o Selami! Ç'bën kështu, o ditëzi?! Një e pive pak më parë dhe dy tani me eks, sikur...

- Selamiu nuk e la ta mbaronte fjalën, por e urdhëroi menjëherë:

- Mbushma dhe më kthe kusurin!

Banakieri u bind. Selamiu mori gotën dhe përsëri e ktheu menjëherë. Një pikë raki iu var poshtë buzës. E fshiu me kurrizin e dorës dhe doli me vrull. Eci me hap të shpejtë. Dukej si i luajtur. Arriti te shtëpia e Sabriut. Shtyu derën e jashtme dhe hyri në oborr. Hodhi sytë sa majtas djathtas dhe si nxori nga poshtë kapotës pushkën, u drejtua për te dera

e hyrjes. E shtyu me forcë dhe hyri në kuzhinë. Nuria ishte shtrirë në divan dhe shihte televizor, ndërsa Sabriu ishte ulur në tavolinë dhe po qëronte një kokërr mollë. Burrë e grua ngrinë kur panë Selamiun aty. Sabriu deshi të thoshte diçka, por Selamiu shtiu menjëherë në drejtim të tij dhe e palosi në vend. Thika dhe kokrra e mollës, gjysmë e qëruar i shpëtuan nga duart dhe ranë mbi qilimin e leshtë. Molla, nisi të rrokullisej ngadalë, derisa ndaloi. Nuria ulëriti. Bëri të ngrihej, por plumbat e goditën në gjoks. Edhe ajo mbeti e vrarë në vend. Skena ishte e llahtarshme: Sabriu i shtrirë sa gjatë gjerë në dysheme dhe me sytë ngulur në tavan, ndërsa Nuria mbështetur në shpinoren e divanit me gojë të shqyer dhe me plagën që i rridhte gjak. Selamiu u hodhi një vështrim të ftohtë viktimave të tij. U afrua pranë tyre dhe, si u bind që nuk merrnin frymë, doli. Mori rrugën nga kishte ardhur. Këtë radhë nuk e fshehu pushkën, por e mbajti në dorë derisa arriti në qendër të fshatit. Rrugës hasi disa fshatarë, që vetëm sa e vështruan, pa pasur guximin t'i flisnin. Në qendër u ndesh me kryeplakun. Kur e pa Selamiun të armatosur, ai u shtang.

- Ç'e ke këtë pushkë, o Selami? Çfarë ke djallosur? - e pyeti me gjysmë zëri.

- Na, merre! Mbarova punë, i vrava! I vrava të katërt ata që më shkatërruan jetën! Tani njofto policinë të vijë e të më marrë, - i tha me gjakftohtësi të jashtëzakonshme, sikur të kishte zbuluar një krim dhe jo të ishte vetë autori i tij.

Pas afro një çerek ore forca të shumta policie mbërritën në fshatin Gjonlekaj dhe arrestuan Selamiun për vrasjen e katërfishtë.

Maj 2014

Kur njeriu prek fundin

Ishte ora 23 e 30 minuta kur Mauro Roveli zbriti shkallët që të çonin në garazh. Mori makinën, një “Golf” në ngjyrë të zezë, dhe u nis në drejtim të shtëpisë së Frankos. Mauroja jetonte në një prej vilave dykatëshe të kompleksit të ri, ndërtuar në atë zonë para disa vjetësh. Ato ishin të vendosura me radhë në krah të njëra-tjetrës. Jetonte bashkë me të shoqen, Antonetën, dhe dy fëmijët, Klarën dhe Kristianin. Klara ishte pesë vjeçe, ndërsa Kristiani ende nuk i kishte mbushur dy. Mauroja kishte mbaruar studimet e larta për informatikë dhe tani punonte në një shoqëri shumëkombëshe gjermane në afërsi të Torinos. Gruaja e tij punonte në një qendër të madhe industriale dhe kishte një rol drejtues. Ishte grua e zonja, e përkushtuar për shtëpinë dhe familjen dhe me parime për jetën. Ishte besimtare dhe mjaft aktive në veprimtaritë që organizonte famullia e fshatit ku jetonin. Ata ishin martuar para shtatë vjetësh dhe gjatë kësaj kohe martesë e tyre kishte kaluar disa peripeci, duke pësuar luhatje, por gjithsesi vazhdonte të qëndronte më këmbë. Kur ishin njohur, Mauroja kishte qenë shumë i ri, ende pa mbushur të njëzetat, ndërsa Antoneta ishte shtatë

vjet më e madhe sesa ai. Ndryshimi i moshës nuk përbënte ndonjë problem për ta. Më parë, rreth orës njëzet e tre, Mauroja i telefonoi shokut të tij të ngushtë, Frankos, i cili jetonte bashkë me të shoqen.

- Franko, do të shkoja ta shikoja ndeshjen në klub, por ndërrova mendje. Si thua, a të vij ta shohim bashkë?

- Ç'është ajo fjalë?! Patjetër, të presim!

Ata kishin një shoqëri të vjetër, me rrënjë të thella njohjeje. Njiheshin që në kopsht. Rrugët e tyre ishin ndarë prej kohësh pas studimeve të larta, por shoqërinë vazhduan ta ruanin si më parë. Në mesnatë kombëtarja e futbollit luante një ndeshje të Kampionatit Botëror. Nga shtëpia e Mauros deri tek ajo e Frankos nuk mbante më shumë se pesë minuta me makinë. Mauroja nuk mori nga rruga “Republika”, që ishte rruga kryesore, por dredhoi në rrugën “Kazali”, një rrugë dytësore. Ishte mesi i muajit qershor dhe nata ishte e ngrohtë. Hëna ndriçonte në qiellin e pastër e të mbushur me yje. Mauroja ndaloi makinën në anë të rrugës. Ndezi dritat e bllokazhit dhe, kur u sigurua se nuk kishte asnjë lëvizje, zbriti nga makina dhe hodhi në kazanin e plehrave një qese me mbeturina. Pas dy-tri minutave mbërriti në shtëpinë e Frankos. Derën ia hapi e shoqja, e cila i uroi mirëseardhjen. Hyri brenda dhe vuri re se aty ishin mbi dhjetë persona të tjerë. I përshëndeti dhe zuri vend në karrigen ku e drejtoi Frankoja.

- Të të sjell një birrë?

- Po, faleminderit!

Frankoja ia solli menjëherë dhe e pyeti:

- Nga shtëpia mirë janë? Si është Antoneta dhe fëmijët?

- Mirë, faleminderit! Çdo gjë në rregull, - ia ktheu buzagaz ai.

Pas pak minutave filloi ndeshja. Të gjithë u mbërthyen nga emocionet e forta të ndeshjes. E ngulën vështrimin në ekranin e televizorit duke ndjekur 22 lojtarët tek rendnin pas topit. E prishën qetësinë dy herë në çastet e shënimit të golave, kur shpërthyen në entuziazëm nga gëzimi. Më shumë nga të gjithë u entuziazmua Mauroja, i cili më pas nuk dinte t'i pushonte komentet për golin e fitores. Pas ndeshjes u kthye në shtëpi. Rrugën e përshkoi me shpejtësi. Futi makinën në garazh dhe u ngjiti lart. Hyri në dhomën e tij. E shoqja dergjej e vdekur në mes të dhomës, mbytur në një pellg të madh gjaku, të shkaktuar nga plagët e shumta në qafë, në kurriz dhe në bark.

- Ndhimë! Ndhimë! - bërtiti me të madhe.

Shkoi në dhomën e fëmijëve. Edhe ata ishin mbytur në gjak, por me të vetmin ndryshim se plagët i kishin në fytyrë. Doli te dera e jashtme dhe thirri përsëri për ndihmë:

- I kanë vranë të gjithë! I kanë vranë të gjithë!

U fut brenda dhe nga telefoni i shtëpisë njoftoi karabinierët duke përsëritur pothuaj të njëjtat fjalë:

- Shpejtoni! Kanë ardhur për të vjedhur dhe i kanë vranë të gjithë! I kanë vranë të gjithë!

Karabinierët dhe ambulanca e ndihmës së shpejtë mbërritën në të njëjtën kohë. Fshati u zgjua nga sirenat e tyre. Në shtëpinë e Mauros ia behën komshinjtë. Ai vazhdoi të ulërinte me të madhe. Një burrë rreth të dyzetave i hodhi dorën në qafë dhe po mudohej ta qetësonte, por ishte tepër e vështirë. Komshinjtë, të tronditur dhe të tmerruar në

kulm, shihnin njëri-tjetrin në sy, pa kuptuar asgjë nga ajo tragjedi që kishte ndodhur pak çaste më parë në atë shtëpi. Nuk arrinin t'u besonin syve.

- O Zot, sa keq po më vjen! I shkreti Mauro, ç'e gjeti! - tha një grua mbi të pesëdhjetat.

- Para dy-tri orësh unë dëgjova të bërtitura therëse nga shtëpia e tyre, por nuk u vura shumë rëndësi, - tha Maria, komshia e vilës në krah.

- Me sa duket, në atë kohë i ka pikasur hajdutët e gjora Antonetë, që kanë hyrë për të vjedhur.

- Eh, ç't'i bësh, ka ardhur kohë e keqe! Kemi frikë të largohemi nga shtëpia, se hajdutët janë bërë të pamëshirshëm. Çfarë t'i bëjmë qeverisë? Ua ka hapur derën të huajve, që jo vetëm na vjedhin, por edhe na vrasin! - u ankua një burrë i thyer në moshë, që banonte dy-tri vila më tutje.

- Maskarenjtë! Po me fëmijët e shkretët ç'kanë pasur! Si u ka bërë dora të vrasin dy engjëj të pafajshëm?! - tha një grua e re në moshë, me flokë të shprishur dhe e veshur me pizhame, e cila, me të dëgjuar ulërimat dhe thirrjet e Mauros, ishte ngritur nga krevati dhe e kishte mbajtur frymën në shtëpinë e tij.

Më pas karabinierët u thanë komshinjve të largoheshin, pasi u duhej të vepronin menjëherë. Nëpër shtëpi kishte rroba të hedhura sa andej-këtej. Kasaforta ishte e hapur. Specialistët e kriminalistikës nisën të bënë matjet e nevojshme. Fotografuan trupat e vararë dhe mjedisin rreth e rrotull. Më pas personeli i ndihmës së shpejtë mori trupat e viktimave dhe i nisën drejt spitalit. Pasi mbaruan me matjet dhe fotografimet, karabinierët mbyllën dyert e dritaret dhe

rrethuan vendin për të mos lejuar hyrjen e personave të tjerë. U larguan nga vendi i krimit, duke marrë me vete Mauron.

* * *

Për hetuesit dhe prokurorin kishte shumë paqartësi dhe mospërputhje faktesh në vrasjen e trefishtë. Nuk kishte thyerje dyersh apo dritaresh, ku mund të dyshohej se vjedhësit kishin hyrë me forcë. Asnjë gjurmë gjaku nëpër dorezat e dyerve apo në dyshtemenë e shtëpisë, veçse në dhomën ku dergjej trupi i pajetë i Antonetës. Arma e krimit nuk gjendej. Kasaforta dukej e hapur normalisht. E vetmja mundësi ishte që hajdutët të dinin numrin sekret të saj, gjë që hetuesit e përjashtonin kategorikisht. Kombinimin e numrit të kasafortës e dinte vetëm Mauroja dhe Antoneta. Dollapët e rrobave, si në dhomën e fëmijëve, ashtu dhe në dhomën e çiftit, vetëm sa ishin hapur. Një portofol mbi tryezë ishte i paprekur. Po ashtu komodinat dhe komoja e madhe, ku hajdutët mund të gjenin sende me vlerë, nuk ishin prekur fare. Gjurmë të tjera këmbësh apo gishtërinjsh nuk kishte. Këto ishin disa nga të dhënat e para që kishin grumbulluar hetuesit në këtë vrasje të trefishtë. Kishte diçka që nuk shkonte, që nuk përputhej. Hetuesit u vunë menjëherë në punë. Mauroja qëndronte ulur në një karrige në mes të dhomës. Kishte ulur kokën dhe duart i mbante mbi gjunjët e përthyer. Në dhomë ndodheshin dy karabinierë, prokurori, dy hetues dhe sekretari, që rrinte ulur para kompjuterit.

- Zoti Roveli, ju lutem na tregoni për ngjarjen dhe na përshkruani në detaje të gjitha lëvizjet tuaja deri në çastin

e telefonatës, - i tha prokurori Mauros. Quhej Enriko. Ishte një burrë i pashëm tek të pesëdhjetat, me flokë të dendur, ku mbizotëronin thinjat. Dukej i qetë dhe zërin e kishte paksa të vrazhdë ngaqë pinte shumë duhan. Prokurori i hodhi një vështrim hetues të pandehurit. Dukej i frikësuar. Nga vështrimi i parë iu krijua përshtypja se nuk do ta kishte të vështirë ta zbërthente. Përvoja ia kishte mësuar një gjë të tillë. Mauroja ngriti kokën dhe u hodhi një vështrim personave që ndodheshin aty. Trupin ia përshkuan mornica. Ndeshi në shikimin dyshues të karabinierëve. Ai shikim sikur i thoshte: “Fol shpejt! Është ora pesë e mëngjesit dhe kemi gjithë natën pa gjumë!”. Ndjeu frikë. Zemra nisi t’i rrihte fort, sa mend iu duk se do t’i shkulej vendit. Largoi vështrimin nga karabinierët dhe ndeshi në atë të prokurorit. Nga t’ia fillonte? Duhej të ishte i saktë në ato që do të thoshte. Më në fund nisi të fliste me gjysmë zëri:

- Rreth orës njëzet e tre i telefonova shokut tim, Franko Botinit. E pyeta nëse mund të shkoja ta shihja ndeshjen në shtëpinë e tij. Unë e kisha lënë që të shkoja në klubin e fshatit fqinj, por ndërrova mendje. Mendova...

- Pse ndërrova mendje? - e ndërpreu prokurori.
- Desha të takoja Frankon, pasi kisha ditë pa e parë.
- A mund ta di kur dole nga shtëpia?
- Rreth orës 23 e 30 minuta.
- Gruaja dhe fëmijët çfarë po bënin kur dole ti?
- Fëmijët kishin kohë që flinin, ndërsa gruaja shkoi në shtrat në çastin që dola unë.
- Cilën rrugë more për të arritur te shtëpia e Frankos?
- Mora rrugën “Republika”.

Prokurori hodhi vështrimin nga sekretari, i cili po shkruante në kompjuter dëshminë e të pandehurit. I bëri shenjë me kokë që të vazhdonte.

- Po më pas? - ndërhyri prokurori.

- Më pas arrita te shtëpia e Frankos. Aty ishin mbledhur edhe shokë të tjerë dhe pamë ndeshjen. Pas ndeshjes u ktheva në shtëpi. Parkova makinën në garazh, u zhvesha aty që të mos bëja zhurmë dhe të mos shqetësoja fëmijët, pastaj u ngjita lart. Kur hyra në dhomën e gjumit, e gjeta trupin e sime shoqeje në një pellg gjaku. U lemerisa! Zbrita poshtë te dera kryesore dhe thirra për ndihmë. Në çast më shkoi mendja të fëmijët dhe më kapi tmerri. U ngjita me vrap lart. Kur hyra në dhomë, pashë që edhe ata i kishin vrrarë. Ngriva i tëri. S'dija ç'të bëja. Kur e mblodha disi veten, ju telefonova juve, - përfundoi rrëfimin Mauroja me kokën ulur.

- Keni gjë tjetër për të shtuar? Ndoshta keni harruar ndonjë detaj të vogël, - tha prokurori.

Mauroja ngriti kokën. Këmbëngulja e prokurorit nuk i pëlqeu. Sytë e tyre u ndeshën përsëri. “Çfarë, nuk më besoni?!”, dukej sikur thoshte vështrimi i frikësuar i tij. “Edhe nuk të besojmë. Ka shumë fakte dhe detaje që nuk përputhen dhe që kundërshtojnë njëri-tjetrin”, i përgjigjej vështrimi i prokurorit.

- Jo, nuk kam asgjë për të shtuar. Jam i tronditur nga humbja e familjes.

Po gdhinte. Ora kishte shkuar pesë e gjysmë. Mauroja dukej i dërrmuar. Kishte mbi dy orë që hetuesit jepnin e merrnin me të.

- Zoti Roveli, si i keni pasur marrëdhëniet me gruan?
Mauros i erdhi e papritur kjo pyetje. Deshi të përfitonte kohë, ndaj bëri të paditurin:

- Nuk po ju kuptoj zoti prokuror!

- A keni pasur konflikte gjatë martesës suaj? - qartësoi pyetjen Enrikoja.

S'po dinte si të përgjigjej. "Çfarë dreqin duan të dinë?! Pse m'i bëjnë këto pyetje?", tha ai me vete.

- Sigurisht që po, - u përgjigj, - por këto kanë qenë mosmarrëveshje të vogla, të parëndësishme, siç ndodh në të gjitha çiftet.

- A keni menduar ndonjëherë të ndaheni nga gruaja? - bëri pyetjen e radhës prokurori.

Kjo pyetje e zuri në befasi Mauron. Marrëdhëniet e tij me të shoqen i dinte vetëm ai dhe pak njerëz të afërm të rrethit të tij.

- Jo, nuk kam menduar asnjëherë ta lë gruan time, - u përgjigj ai duke hetuar fytyrën e prokurorit për të kuptuar efektin e përgjigjes së tij.

- Ashtu?! Po thoni të vërtetën? Duhet t'ju besoj?

- Po, them të vërtetën, - u përgjigj thatë Mauroja.

Prokurori e vështroi gjatë. Deshi të lexonte të vërtetën që fshihej brenda syve të tij të picërruar nga lodhja e nga pagjumësia. Mauroja nuk i bëri dot ballë vështrimit hetues të syve tij. Uli kokën. Prokurori iu drejtua hetuesve:

- Lokali duhet të jetë hapur tani, a dalim të pimë një kafe?

- Dalim. Edhe unë e kam të nevojshme. Kemi gjithë natën pa gjumë, - tha njëri prej tyre.

Ata dolën dhe Mauroja mbeti vetëm me sekretarin, i cili vazhdonte të hidhte të dhëna në kompjuter. Filloi të dyshonte. Ata dinin shumë për jetën e tij, më shumë nga ç'mendonte ai. U zhyt në mendime. Jeta e tij me Antonetën nuk kishte qenë aq e lehtë. Një javë para se të martoheshin ai e kishte lënë atë. Nuk ishte i bindur në martesën e tij. Sapo kishte hyrë në vitin e njëzet e gjashtë të jetës. Antoneta kishte arritur ta bindte dhe pas një jave i ish-in drejtuar altarit për të kurorëzuar lidhjen e tyre. Ajo veshur me të bardha dhe ai me smoking, mes puthjeve e lotëve kishin celebruar martesën. Kishin kaluar disa kohë pas lindjes së vajzës dhe lidhja e tyre kishte pësuar të çara të thella, por falë zgjuarsisë dhe tolerancës së saj kishin ecur përpara. Lindja e djalit sikur i kishte qetësuar disi ujërat e turbulluara që rridhnin nën shtratin martesor. Mauroja dukej tepër i lodhur nga jeta bashkëshortore. Qetësinë e gjente në vendin e tij të punës, në shoqërinë e Anës, për të cilën zemra i rrihte fort dhe mendja i errësohej sa herë i hidhte vështrime. Shpesh i lutej që të rrinin më gjatë pas orarit të punës ose e ftonte të pinin kafe apo të hanin jashtë. Ana ishte vajzë e zgjuar dhe nuk binte lehtë pre e dëshirave të tij, por gjithsesi ia plotësonte herë pas here si me pikatore. Ajo ishte e fejuar dhe së shpejti do të martohej. Kjo ishte arsyeja që gjatë javës kthehej vonë. I justifikohesh së shoqes se kishin shumë punë dhe qëndronte jashtë orarit. Sapo kthehej në shtëpi, ledhatonte fëmijët, ndërsa asaj i qëndronte ftohtë.

Megjithatë, në sytë e të tjerëve Mauroja mendohej të tregohej njeri familjar. Të shtunave shkonte me të shoqen për të bërë blerjet e javës. Të dielave paradite shkonin rregullisht në kishë. Gjatë javës, kur mundej, merrte fëmijët dhe i nxirrte shëtitje.

Pas disa minutave prokurori dhe dy hetuesit u kthyen. Mauro e gjetën të përhumbur në mendime.

- Zoti Roveli, kemi edhe disa pyetje të tjera për t'ju bërë, vazhdojmë? - i drejtua prokurori.

Mauroja tundi kokën në shenjë pohimi, pa mundur të hapte gojën. Po i mbylleshin sytë dhe do të kishte dashur që edhe ai të kishte pirë një kafe si ata të tre.

Prokurori e vuri re gjendjen e tij dhe e pyeti:

- Dëshironi ndonjë gotë ujë, një kafe apo ndonjë gjë tjetër?

Sapo dëgjoji fjalën “kafe”, sikur iu hapën sytë dhe shpejtoi të përgjigjej:

- Po, me gjithë dëshirë do ta pija një kafe!

Prokurori urdhëroi njërin nga vartësit e tij, i cili u ngrit menjëherë dhe pas pak ia solli kafënë, të cilën ai e rrufti menjëherë. Kafeja sikur ia mblodhi shpirtin dhe dukej i gatshëm të vazhdonte më tej.

- Zoti Roveli, çfarë marrëdhëniesh keni me zonjushën Ana Kolina?

Mauroja shtangu. Uli sytë. Nuk e priste një pyetje të tillë. I erdhi si një rrufe në qiell të pastër. Iu duk sikur dikush e goditi fort. U mundua të përgjigjej, por nuk mundi të hapte gojën. Kaluan disa sekonda. Ngriti sytë dhe ndeshi në sytë zhbirues të prokurorit. Hodhi vështrimin nga të tjerët: edhe ata e kishin përqendruar vëmendjen mbi të dhe prisnin me padurim përgjigjen e tij. Vështrimet e tyre iu dukën edhe më të rënda. E ktheu përsëri shikimin nga prokurori.

- Jemi kolegë pune, - u përgjigj me gjysmë zëri.

- Kolegë pune apo diçka më shumë se kolegë?

- Nuk po ju kuptoj!

- Keni lidhje intime me njëri-tjetrin?

Këtë herë iu duk sikur i erdhi një grusht edhe më i fortë.

- Jo! - u përgjigj ftohtë me kokën ulur.

- Si është e mundur që numri juaj i telefonit gjendet në shumë telefonata të zonjushës Kolina në orë të ndryshme dhe më shumë të shtunave dhe të dielave? Kemi hyrë në faqen tuaj të internetit dhe kemi parë e lexuar të gjitha mesazhet tuaja. Ju lutem, zoti Roveli, na tregoni dhe mos u mundoni të fshihni të vërtetën, sepse kjo ju rëndon më tepër.

Mauroja nuk mundi të hapte gojën. Ky ishte grushti i nokautit, që e hodhi përfundimisht në tapet. Nuk mund të ngrihej më. U ndje i mundur. U shemb si një thes i rëndë, që bie përdhe me forcë. Iu duk sikur poshtë këmbëve e përpiu vorbullla, duke e tërhequr poshtë e më poshtë drejt greminës. E kuptoi fundin e tij. Ishte e kotë të trillonte dhe të bënte viktimën, siç kishte bërë deri në ato çaste. Nuk mund të mbrohej më. Ata dinin çdo gjë. Nisi të tregonte:

- Po, jam unë që i vrava. Doja të çliroheshja prej tyre. Dashuroja një femër tjetër, Jam çmendur pas saj. Nuk mund të rrija as edhe një minutë pa e parë dhe pa i dëgjuar zërin. Unë nuk...

- Ju fare mirë mund të ndaheshit nga gruaja, pa qenë nevoja të shkaktonit gjithë këtë tragjedi, - e ndërpreu prokurori.

- Po, zoti prokuror, por unë nuk guxoja ta lija gruan. Nuk e di as vetë. Provova ta bëja një gjë të tillë para dy vjetësh, para se të lindte djali, por nuk ia arrita. Me lindjen e tij gjërat sikur ndryshuan dhe lidhja jonë nisi të funksiononte disi. Përpiqesha të isha një bashkëshort dhe baba i mirë, por, me sa duket, nuk ia arrita. Gruan në fillim e doja, por me kalimin e viteve ajo m'u ftoh dhe u pendova për martesën.

- Dhe për të ngrohur dashurinë ju provuat të kishit një lidhje jashtëmartesore me një femër tjetër, që edhe ajo nuk ishte e lirë! - ironizoi prokurori. - Ju e dini që është e fejuar, apo jo?

Mauroja rrinte i tulatur me kokën ulur dhe nuk ishte e vështirë të kuptonte ironinë therëse të prokurorit.

- Po. Nuk isha i kënaqur nga martesja dhe doja të kisha një lidhje tjetër, - u përgjigj ftohtë pa i ngritur aspak sytë.

- Zoti Roveli, po zonjusha Ana Kolina a ju dashuron?

Mauro ngriti sytë dhe vështroi prokurorin. E hetoi një çast për të kuptuar se çfarë mund të dinte më tepër ai rreth lidhjes së tij me Anën. Nuk dinte si t'i përgjigjej. T'i thoshte të vërtetën, apo të dredhonte? Ishte në mëdyshje. Pas pak e theu heshtjen:

- Po, edhe ajo më dashuron, ndaj e kisha humbur mendjen pas saj. Ajo është shpresa ime për të vazhduar jetën, pasi me gruan nuk mund ta shtyja dot më.

- Nga të thënat e saj na del e kundërta. Zonjusha nuk është e dashuruar me ju, sepse ajo dashuron një djalë tjetër dhe së shpejti do të shkojnë të jetojnë bashkë. Ajo na tha se kishit vetëm marrëdhënie pune dhe asgjë më tepër. Jeni ju ai që i vardiseni dhe nuk e lini rehat në çdo hap që ajo hedh. Me sa dimë ne, ajo nuk ju ka premtuar asgjë. Është e vërtetë kjo, zoti Roveli?

- Jo, nuk është e vërtetë! Ajo më dashuron, dhe për këtë jam i sigurt, - tha ai.

- Ne kemi përpara deklaratën e saj, ku tekstualisht ka thënë se nuk mund ta ndërronte dashurinë për të fejuarin e saj me një tjetër, aq më pak me një të martuar si puna juaj, - i tha prokurori duke i zgjatur një letër të firmosur. Mauroja

hodhi shikimin vjedhurazi në fund të fletës dhe njohu firmën e Anës. Po, po, ishte firma e saj. Sa herë e kishte parë atë firmë të hidhej nga dora e saj, që ai mendohej ta prekte si pa dashje, ndërsa ajo i buzëqeshte dhe i largohej me marifet! Sa herë e kishte kapur nga beli dhe e kish shtrënguar fort rreth vetes me epsh e i kishte vjedhur puthje! Ai kishte këmbëngulur aq shumë, sa puthjet e vjedhura më pas ishin kthyer në dhurata nga ana e saj. Nuk arrinte ta kuptonte pse ajo e kishte mohuar dashurinë e tyre. Ishte e vërtetë që ajo i kishte thënë se ndërmjet tyre kishte një pengesë shumë të madhe, dhe kjo ishte familja e tij, por ai i kishte premtuar se do të bënte të pamundurën, do të sakrifikonte që të shkëputej prej tyre dhe të jetonte me të. E dinte që ajo donte prova për dashurinë dhe ai i kishte premtuar se do t'ia jepte ato. Firma në fundin e letrës ia errësoi gjykimin dhe ndjeu t'i ndizej gjaku nga zemërimi. Gjithsesi, nuk deshë ta bënte me faj Anën. Ndoshta e pyetur nga karabinierët pas kësaj tragjedie ajo nuk mund të thoshte se ishte e dashuruar me të.

- Gruaja juaj e dinte dashurinë që kishit ju për Anën? - e shkundi nga mendimet Albertoja, njëri nga hetuesit, që deri në ato çaste nuk kishte folur fare, pasi të gjitha pyetjet i kishte bërë prokurori.

Mauroja nuk foli. E kishte mendjen tek Ana. “Sigurisht, ajo kërkon të dalë e papërlyer në këtë histori, ndaj i ka mohuar të gjitha”, mendoi.

- Zoti Mauro, a mund të përgjigjeni? - e kujtoi Albertoja.

Mauroja u mendua një çast dhe më pas me gjysmë zëri tha:

- Po, e dinte që unë isha i dashuruar me kolegen, por ne kishim bërë një marrëveshje. Ajo më kishte dhënë kohë dhe

mundësi që unë të reagoja ndaj veprimeve të mia. Ajo ishte gati të më falte çdo gjë për hir të familjes, sidomos për hir të fëmijëve.

- Dhe ju ia shpërblyet në këtë mënyrë duke i marrë jetën!
- ironizoi Albertoja duke e ngritur tonin e zërit. - Vazhdoni!
Na tregoni çfarë ndodhi dhe si e kryet krimin!

- Unë dhe ajo ishim në dhomë, po bënim dashuri, ndërsa fëmijët i kishim vënë në gjumë. Pasi mbaruam, unë u ngrita, veshja të mbathurat dhe vajta në kuzhinë për të marrë një thikë. Antoneta ishte duke u veshur dhe nuk më vuri re, pasi më kishte kthyer kurrizin. E godita me thikë, në fillim në qafë dhe më pas ia ngula në shpinë. Lëshoi një ulërimë therëse e duke u kthyer nga unë më tha: “Jooo! Psee? Psee, Mauro?”. Duke e parë drejt e në sy, ia ngula në bark dhe aty ra përtokë. Duke mos m’i shqitur sytë, u përpoq të mbrohej dhe u ngrit me vështirësi që të ikte. E kapa te dera dhe e godita me grusht me sa fuqi që kisha. Ra përdhe. E lashë të mbuluar në gjak. Shkova në dhomën e fëmijëve. Në fillim vrava vajzën e më pas djalin duke ua ngulur thikën në fytyrë. Ora nuk kishte vajtur akoma njëmbëdhjetë. Zbrita poshtë në bodrum, pasi edhe aty kemi një dush, dhe u lava për të hequr njollat e gjakut që më kishin mbetur në trup.

- Dhe aty u treguat i pakujdesshëm për të fshehur gjurmët e krimit. Në të mbathurat e tua ne gjetëm një njollë gjaku, që ju nuk e keni vënë re, - e ndërpreu hetuesi tjetër me emrin Xhenaro, një burrë zeshkan me trup mesatar.

Mauroja ngriti sytë i habitur për këtë fakt komprometues. Ai ishte treguar i kujdesshëm në fshehjen e fakteve, sidomos fshehjen e gjurmëve të gjakut. Po me sa dukej, nga shpejtësia nuk e kishte vënë re pikën e gjakut, që i kishte rënë në të

mbathura, kjo pikë kishte qenë fatale për të. Pikërisht ajo njollë gjaku kishte qenë pikënisja e dyshimeve të hetuesve. Ai nuk foli, vetëm uli kokën. E kuptoi se zor të shpëtonte pa u dënuar pas gjithë atyre provave që po i viheshin kundër.

- Po më pas çfarë bëre? - e pyeti prokurori.

Mauroja ngriti kokën. Sytë e tij ishin të ftohtë, të akullt. Fytyra i dukej si një maskë. Asnjë muskul nuk i lëvizte. Enrikos i bëri përshtypje. “Si është e mundur që ka një gjakftohtësi të jashtëzakonshme, sikur asgjë të mos ketë ndodhur?! Si është e mundur që njeriu vret gruan dhe fëmijët, njerëzit e tij më të dashur, dhe nuk ndien asnjë lloj dhimbjeje?! Si ka mundësi që pas një krimi të tillë makabër shkon në shtëpinë e shokut të tij dhe me qetësinë më të madhe, madje duke pirë, shikon një ndeshje futbollit?! Vërtet qenia njerëzore është kaq e ndërlikuar dhe e pashpjegueshme?! Vërtet ka arritur deri aty sa të prekë fundin?!”, tha me vete teksa po e vështronte me vëmendje. Ishte vërtet një rast i jashtëzakonshëm, i veçantë. Kishte marrë në pyetje njerëz të të gjitha kategorive: kriminelë, hajdutë ordinerë, imoralë, prostituta, profesorë, mjekë, inxhinierë, që dridheshin dhe jargaviteshin kur ndodheshin para tij, por njeri pa zemër dhe me fytyrë të akullt si ky nuk kishte ndeshur asnjëherë. Do të kërkonte ta dënonin me burgim të përjetshëm, që të mos e shikonte kurrë dritën e diellit. Nëpër mend i shkoi një mendim tjetër, që ia gërvishti trurin: sikur t’ia lejonte ligji, do të kërkonte varje ose pushkatim për këtë monstër me fytyrë engjëlli për masakrën e kryer me një gjakftohtësi platonike. Nga këto mendime e shkëputi zëri i ftohtë i Mauros, që iu përgjigj pyetjes së tij:

- Fillova të bëja rrëmujë nëpër shtëpi. Hapa dollapët e rrobave, sirtarët e komosë dhe të komodinave, nxora dhe portofolin tim, që nuk e mbaj mend nga e hodha.

Prokurori qeshi dhe shtoi me ironi:

- Ju nuk e kishit bërë siç duhet planin. Aty bëtë një gabim taktik, që nuk ju falet. Portofoli juaj ishte me para. Asnjë hajdut apo kriminel nuk do ta linte ashtu të fryrë. Në dorezat e dyerve dhe të dritareve, te çelësat e dritave dhe te kasaforta nuk u gjet asnjë gjurmë gjaku, madje kasaforta ishte hapur pa asnjë lloj sforcimi, sepse atë e kishe hapur ti, që dije numrin sekret. Dhe pasi mbaruat me rrëmujën, i telefonuat shokut tuaj, Franko Botinit, gjoja për të parë ndeshjen. Apo s'është kështu? Duke parë ndeshjen bashkë me shokë të tjerë ju donit të ishit sa më i besueshëm dhe të kishit një alibi shumë të fortë. Është kështu apo jo, zoti Roveli?

Mauroja nuk foli, vetëm pohoi me kokë.

- Po armën e krimit ku e fshehët, sepse në shtëpi nuk e gjetëm?

- Kur dola nga shtëpia, e hodha në kazanin e plehrave në rrugën "Kazali". Për këtë që kam bërë dua të më jepni maksimumin e dënimit! - tha i qetë, sikur të mos bëhej fjalë për masakrimin e familjes së tij.

Korrik- gusht 2014

Gabimi fatal

Françeska kishte ditë që nuk ndihej mirë. Zgjohej në mëngjes me dhimbje koke dhe barku. Nuk i kishte ndodhur kurrë më parë. Vendosi të vizitohej. Një mëngjes shkoi te mjeku i familjes.

- Asgjë shqetësuese, megjithatë, për të të hequr merakun, po të jap një fletë analizash për gjakun. Të shohim si do të dalin dhe më pas bëjmë ndonjë mjekim, nëse do të jetë e nevojshme, - i tha mjeku.

Pas dy ditësh, me makinën e saj u drejtua për në spitalin “Shën Maria”. Ishte një mëngjes i freskët tetori dhe dielli sapo kishte nxjerrë kryet pas Apenineve. Kur zbriti nga makina ndjeu të rrëqethura. Kishte frikë. Zemra sikur nuk po i ndillte mirë.

Vajtën në spital për të bërë analizat dhe e mbajti tepër sekret; as Antonios, bashkëjetuesit të saj, nuk i tregoi. Antonio ishte nga Jugu i Italisë, por ishte ngjitur në veri për punë. Me të njihej që prej dhjetë vjetësh. Kishin katër vjet që bashkëjetonin. Më në fund kishin vendosur të martoheshin. Ishin moshatarë dhe po mbushnin të tridhjetat. Kohët e fundit po kërkonin të blinin një shtëpi. Si çift shkonin shumë. Ishin të dy të gjatë dhe me pamje tërheqëse. Françeska ishte

vajzë e bukur, me sy e flokë të zinj e të gjatë, që i binin mbi supe si dallgët e detit. Ishte nga ato lloj femrash që bien në sy menjëherë, që padashur i detyrojnë meshkujt të kthejnë kokën dhe t'i vështrojnë me ëndje. Atë ditë kishte veshur pantallona doku elastike, ngjyrë bezhë, të cilat ia tregonin bukur këmbët e gjata e të drejta, një këmishë po në atë ngjyrë dhe sipër një xhakavento të lehtë ngjyrë kafe. Këpucët me takë të lartë e të hollë e tregonin edhe më seksi. I përshkoi ato dyqind metra deri te hyrja e spitalit me hap të ngadalhtë. Mori majtas korridorit dhe u drejtua për te salla ku bëheshin analizat. Hodhi një vështrim të shpejtë: kishte shumë njerëz. Priti në radhë për të marrë numrin e më pas u ul në një karrige që ishte e lirë. Nxori nga çanta një libër dhe nisi të lexonte. Herë pas here ngrinte kokën dhe u hidhte një sy numrave që shfaqeshin në tabelën elektronike. Priti afro një orë derisa i erdhi radha.

- Pas një jave është gati përgjigjja e analizave. Tani po me këtë numër shkoni në sallën ku merret gjaku, që ndodhet përballë, - i tha arkëtarja kur bëri pagesën. Në sallën ku merrej gjaku gjeti një vend të lirë dhe u ul. Në krah kishte një grua të bëshme rreth të dyzetave. E përshëndeti me një buzëqeshje. Deshi të nxirrte librin dhe të lexonte derisa t'i vinte radha, por gruaja në krah nisi ta pyeste:

- Pse po i bëni analizat?

- Po ja, si të të them, kam pasur disa shqetësime këto kohët e fundit dhe u bëra pak merak, - u përgjigj Françeska.

- Aha, unë mendova se mos bëni ndonjë kontroll për shtatzëni. Oh, më falni, se nuk ju pyeta, a jeni e martuar?

- Jo, jo, nuk jam e martuar. Kam disa vjet që bashkëjetoj me një djalë dhe vitin e ardhshëm kemi vendosur të martohemi, - sqaroi Françeska.

- E po, atëherë, së shpejti do të vish këtu për atë që të pyeta unë, - i tha duke qeshur gruaja e bëshme.

- Aha, nuk e di! - ia ktheu Françeska po me buzëqeshje e më pas e pyeti: - Po ju pse po i bëni analizat?

- Jam shtatzënë dhe po bëj kontrollin periodik.

- Sa fëmijë keni?

- Kam dy fëmijë: një djalë dhe një vajzë.

- Urime!

- Faleminderit! Kjo është shtatzënia e tretë dhe e fundit, - tha gruaja duke i shoqëruar fjalët me një lëvizje të dorës, që për të tregonte se i kishte dhënë fund një herë e mirë shtatzënisë.

Më pas ato e ndërprejnë bisedën, sepse panë numrat e tyre në tabelën elektronike. Në fillim hyri gruaja e bëshme, së cilës Françeska nuk ia mësoi emrin.

Dita kur do të merrte përgjigjen e analizave iu duk sikur nuk do të vinte kurrë. Java që kaloi ishte një torturë e vërtetë për të. Ishte shumë e shqetësuar. Dhimbjet e kokës dhe të barkut i dukeshin sikur i shtoheshin gjithnjë e më shumë. Mendja i shkonte gjithnjë për keq. Si mori përgjigjen, shkoi përsëri te mjeku i saj.

- Analizat tregojnë se jeni shtatzënë, - i tha ai.

- Ashtu?! - shqeu sytë ajo e habitur.

- Nuk po gëzoheni që jeni shtatzënë?

- Po... jo, po gëzohem! Më erdhi kaq e papritur, sa nuk arrij ta besoj, - u përgjigj ajo e çoroditur dhe e bërë flakë e kuqe në fytyrë.

- E kuptoj gjendjen tuaj. Sigurisht, është shtatzënia e parë dhe vërtet është diçka befasuese. Besoj se burri juaj